



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 14.05.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Albana Vokshi – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Seancë dëgjimore me një grup artistësh në lidhje me çështjen e Teatrit Kombëtar.
2. Fillimi i diskutimit nen për nen të projektligjit “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” (*komision përgjegjës*).

Marrin pjesë

Albana Vokshi, Milva Ekonomi, Ylli Fideli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Fatmir Velaj, Adelina Rista, Fadil Nasufi, Ismet Beqiraj, Bujar Çela, Almira Xhembulla, Luçiano Boçi, Luan Baçi, Romeo Gurakuqi, Valentina Duka, Kejdi Mehmetaj, Shezai Rrokaj, Besnik Baraj (*deputet zëvendësues*), Anduel Xhindi (*deputet zëvendësues*).

Mungon:

Nora Malaj.

Të ftuar:

Alert Çeloaliaj – kryetar i sindikatës SASE (*Sindikata e Artistëve të Skenës dhe Ekranit*),
Taulanda Jupi – regjisore dhe pedagoge në Universitetin e Arteve,
Kastriot Çipi – regjisor dhe anëtar i sindikatës.

HAPET MBLEDHJA

(Fillon mbledhja pa incizim.)

Milva Ekonomi – (Sqarime në lidhje me projektligjin “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”) Romeo erdhi dhe tha se do të jepte komentet për tri çështjet kryesore, pasi i duhej të largohej, sepse kishte një konferencë në Prishtinë.

Albana Vokshi – Milva, sa nene kanë kaluar?

Milva Ekonomi - Kohë kemi sa të duash.

Albana Vokshi – Jo, nuk kemi kohë.

Milva Ekonomi – Ju lutem, më lini....

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, më lini të mbaroj fjalën!

A mund ta vë në dijeni komisionin se çfarë ka ndodhur?

Ditën e parë, në orën 11:00, u paraqitëm Romeo, Vali, unë, përfaqësuesit e ministrisë dhe këshilltarët tanë. Nora Malaj më mori në telefon dhe më tha që kishte mbesën shumë sëmurë. Kishte një situatë urgjente dhe po këshillohej ku ta çonte mbesën për ta shëruar. Romeo erdhi dhe tha se nuk do të mund rrinte gjatë gjithë kohës, ndenji këtu rreth 2 orë e gjysmë, dha komentet e veta për të gjitha pjesët e ligjit dhe tha se i duhej të shkonte në Kosovë, sepse kishte konferencë. Ne të tjerët: unë, Vali dhe grupi punuam. Kaluam në gjysmën e rekomandimeve të çdo pjese, kishim 46 faqe nga tonat, u panë në grup 23, pra gjysma e të gjitha rekomandimeve që kishte bërë Komisioni i Ligjeve. Ramë dakord që në fund të ditës së punës, që mbaroi rreth orës 15:30, do të ndanim informacionin me *track change* për të gjithë. Gjithashtu, ramë dakord që të nesërmen në ora 11: 00 të mblidheshim. Ne erdhëm, por Vali nuk erdhi se kishte një konferencë që e kishte harruar, Nora tha jam shumë sëmurë, Romeo nuk ishte, atëherë vendosëm...

Albana Vokshi- Kush vendosi?

Milva Ekonomi - Fola në telefon me Valin, me Norën dhe ramë dakord në mënyrë telefonike që t'i shikoja unë me grupin që kishte ardhur çdo koment nen për nen dhe në fund të ditës t'ia kaloja edhe Valit, edhe Norës për të parë komentet. Kjo gjë mbaroi të mërkurën rreth orës 3:30. Të enjten fola me Norën në seancë. Ajo më tha se kishte qenë e sëmurë, sepse, përveç mbesës, kishte qenë edhe me shiatik, por më dha fjalën që kishte për ta parë materialin. Vali tha se nuk arriti ta shikonte. Në fakt, të gjithë e kanë marrë informacionin.

Tani, projektligji është parë nen për nen, është futur çdo koment që ka ardhur nga të gjithë, ka mbetur një çështje që nuk e zgjidhëm dot as me Valin, as me komisionin, çështja e definicionit të rijetëzimit. Meqë nuk po gjenim një gjë edhe nga kërkimet në UNESCO, ju la detyrë ministrisë dhe grupit të ADP-së të bënte një definicion. Këtu ishin: ministria, studioja dhe ADP-ja. Domethënë, ne e kemi kaluar të gjithë këtë projektligj. E kemi shpërndarë me *e-mail*. Atëherë, pse thoni që nuk është bërë? Ne ramë dakord për ta bërë punën kështu.

Albana Vokshi – Faleminderit shumë për sqarimin! Ajo që po them unë është që Vali nuk ka mundur ta shohë, edhe Nora nuk ka mundur ta shohë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nëse doni ta bëni në mënyrë të njëanshme, vazhdoni, Milva, ulë zërin! Po flasim si njerëz.

Milva Ekonomi - Nuk e ul zërin.

Albana Vokshi- Të mos zihemi për politikë.

Milva Ekonomi- Ne po zihemi për teknikë, nuk është fjala për politikë.

Albana Vokshi – Ju lutem, mos më ndërhyjni kur flas, se unë nuk ju ndërhyra.

Ajo që po them është se edhe të enjten, edhe të premten unë kam folur me Valin dhe me Kejdin, por asnjëra nga ato nuk kanë pasur mundësi të jenë në ato mbledhje që ju i kishit shumë urgjente. Në mbledhjen e parë më ke thënë se keni kaluar 26 nene. Në rregull, i keni përfshirë të gjitha komentet. Pjesën tjetër nuk e keni kaluar si grup pune. Vali, Nora dhe Romeo nuk kanë pasur kohë t'i shikojnë. Projektligji nuk është përfunduar.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ku e ke parë këtë?

Milva Ekonomi - Është përfunduar projektligji, kanë ardhur komentet. Pse të mos e përfundojmë projektligjin?

Albana Vokshi – Kemi rënë dakord ta shohë grupi i punës. Nëse ju tërhiqeni nga kjo...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva, qetësohu se do të sëmuresh.

Milva Ekonomi- Nuk jam e nxehur, ne e kemi çuar deri në fund punën.

Albana Vokshi - Milva, ti nuk je treguar korrekte, ti e dije këtë. Unë ta kam dërguar këtë dhe ta kam thënë çështjen e artistëve. Nuk mund t'i nxjerrësh tani artistët dhe t'u thuash që nuk ka mbaruar punë grupi i punës...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk e ka mbaruar grupi i punës ende. Na jepni më shumë kohë që të vijmë me një draft. Nuk po themi që nuk do ta bëjmë. Vali, Nora dhe Romeo nuk kanë qenë se kanë pasur urgjenca të tjera. Nuk i janë përgjigjur dot urgjencës që kishit ju. Ti ke sjellë prapë sot këtu një draft të njëanshëm. Atëherë pyetja është: A do të vazhdojmë sikurse ka vendosur komisioni? Po e them me shumë qetësi dhe me vullnetin për të bërë diçka të mirë. Nëse ju nuk doni, vazhdoni dhe bëjeni!

Po, Kejdi.

(Kejdi Mehmetaj ndërhyrje pa mikrofon)

Milva Ekonomi – Nuk thashë këtë gjë.

(Ndërprerje incizimi.)

Albana Vokshi – Meqenëse ju jeni mbledhur me urgjencë shumë të madhe për një ligj që nuk ka asnjë urgjencë, tani a doni ta bëni me pjesën tonë apo doni ta bëni vetëm? Është e thjeshtë.

Milva Ekonomi – Ne nuk duam ta bëjmë pa pjesën tuaj, por ne nuk duam ta shtyjmë pa fund këtë gjë.

Albana Vokshi – Për çfarë ke ardhur, Besnik? Vjen fut një batutë dhe ikën? Tani na lër! Po të rrish më shumë dhe po të mos vish për *shou*, veç për 5 minuta, do ta kuptosh se nuk është ashtu siç mendon ti se është.

Kanë ardhur përfaqësuesit e sindikatës dhe po presin. Me mirëkuptimin tuaj, a mund të...

Më falni, profesor, se nuk e kisha mbaruar.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Rrimë dhe e zgjidhim pastaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mbarojmë me artistët dhe rrimë ta zgjidhim këtë çështje.

Milva Ekonomi – Edhe ky është mirëkuptim. Siç është mirëkuptimi për atë që mbrëmë nga sekretaria e morëm vesh që do të...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Kur është dërguar njoftimi për komisionin?

(Diskutim pa mikrofon.)

Ariana e ka dërguar njoftimin qysh të mërkurën.

(Diskutim pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Kjo është gjëja që ka ndodhur, mbrëmë erdhi informacioni...

Albana Vokshi – E ka dërguar Ariana.

Milva Ekonomi – Është njëlloj muhabeti që bëjmë tani, simetrik “ka qenë Vali, s’ka qenë Vali”.

Ne treguam gatishmërinë për të ardhur në këtë dëgjese.

Albana Vokshi – E keni detyrim me Rregullore!

Milva Ekonomi – Nëse e kemi me detyrim, të zbatojmë edhe kalendarin që kemi rënë dakord!

Albana Vokshi – Në bazë të një vendimi që ka marrë komisioni...

Do të vazhdojmë t’i lëmë jashtë ata?

Milva Ekonomi – Do të biem dakord që ligji për teatrin do të hyjë në rend të ditës.

Albana Vokshi – Këtë nuk e vë dot si kusht ti!

Ne nuk jemi dakord, se nuk jemi gati. Vazhdojeni ju!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

I ke parë 26 nenet, se unë nuk i kam parë! Prisja draftin e integruar.

(Diskutim pa mikrofon.)

E kam parë *e-mail*-in.

Milva, t’i fusim të ftuarit dhe të mbarojmë?

Fidel Ylli - Albana, mund të them diçka?

Unë mendoj të merremi me këto procedura, jemi të detyruar t’i dëgjojmë ata! Na kanë njoftuar në darkë apo në mëngjes, ne nuk mund t’i shmangemi, sepse është problem sensitiv për të gjithë ne. Të vijnë këta të Teatrit, të dëgjojmë problematikat dhe pastaj ulemi dhe i dëgjojmë deri në darkë. Janë diskutime të kota do të vijnë apo s’do të vijnë! Thirri të vijnë e vazhdojmë programin.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

T’u japim një afat, t’u lëmë një kohë, se nuk mund të presim pafundësisht.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

T’u japim një hapësirë kohe, një orë apo një orë e gjysmë, që të flasim, të mbajmë shënim çfarë problemesh kanë dhe pastaj të vijë ministrja.

Albana Vokshi – A mund t’i thërrisni të futen brenda?

(Diskutim pa mikrofon.)

Mirëmëngjesi!

Ju kërkoj ndjesë që ju lamë të prisni!

Arsyeja e vetme ishte se kishim përplasje me një mbledhje tjetër të komisionit. Ishte parashikuar nga maxhoranca fillimi i diskutimit nën për nën të projektligjit “Për trashëgiminë kulturore” në të njëjtin orar, ndaj u munduam të vendosnim se cila prej pikave të rendit të ditës do të shqyrtohej në fillim. Me miratimin e të gjithë deputetëve vendosëm të bënim dëgjuesën me një grup artistësh në lidhje me çështjen e Teatrit Kombëtar.

Dua t’ju vë në dijeni, që të nesërmen e ditës që pranua ftesën tuaj dhe morëm pjesë në takimin që kishit organizuar në Teatrin Kombëtar, nëse nuk gaboj, ishte para një jave, një grup deputetësh të opozitës kanë bërë një kërkesë për mua, si kryetare, të bëj një dëgjuesë me ju dhe me ministren e Kulturës. Asaj i kemi dërguar në mënyrë të vazhdueshme një *e-mail*/kujtesë për të na kthyer përgjigje, por vetëm para dy ditësh ktheu përgjigje se kishte një axhendë të ngjeshur dhe e kishte të pamundur të merrte pjesë. Nuk është gjë e çuditshme! Ndodh rëndom që ministrat e kësaj qeverie refuzojnë të paraqiten para komisionit, në shkelje të Kushtetutës, në shkelje të ligjit për statusin e deputetit dhe në shkelje të Rregullores. Të gjitha këto e detyrojnë ekzekutivin që të raportojë para komisionit.

Për të mos e zgjatur, pasi kemi vendosur që do të jeni ju ata që do të flisni dhe do të na shprehni të gjitha shqetësimet tuaja lidhur me Teatrin, pranua këtë takim me sindikatat, të fokusuar më së shumti në çështjet kryesore dhe sensitive, siç është ajo e Teatrit.

Zoti Boçi do të marrë fjalën për procedurë.

Luçiano Boçi – Shqetësimi im është ai që shprehët edhe ju, përsëritja e mospranimit të ministres për t’u paraqitur në seancë dëgjimore për çështjen e teatrit, madje, do të thosha se pas katër refuzimesh, herën e pestë, ministrja është larguar në mënyrë demonstrative gjatë debatit që kemi zhvilluar dhe sërish nuk pranon të vijë në komision për këtë çështje kaq sensitive jo vetëm për artistët, por edhe për mbarë opinionin publik.

Justifikimi që ka sjellë duket i bazuar, çështje axhende, etj., ndërkohë nëse i referohemi Rregullores së Kuvendit, neni 102 e detyron ministren të lërë axhendat e veta dhe të paraqitet menjëherë pranë komisionit përkatës për arsye të ushtrimit të kontrollit parlamentar. E ka për detyrë ta bëjë parlamenti, në këtë rast, komisioni ynë.

Kam një shqetësim, sepse mënyra e sjelljes së ministrave, po fus edhe ministren e Arsimit në këtë rast, ndaj komisionit tonë, është rast i përsëritur. Është një lloj arrogancë e pashpjegueshme në kuptimin e teknikës së sjelljes, sepse nga mënyra si qeverisin, e kuptoj shumë mirë arrogancën e kësaj qeverisjeje, por do të kërkoja nga ky komision gjetjen e një modaliteti ligjor të sjelljes së

ministrave. Kërkoj bashkëpunimin e maxhorancës në seancë dëgjimore, sepse është një nga funksionet tona kryesore, nuk është thjesht vetëm ngritja e dorës për **iks** ligj të caktuar, por janë edhe seancat dëgjimore. Rregullorja e përcakton qartë, ministrja duhet të vijë menjëherë. Refuzimi dhe mosballafaqimi me artistët tregon frikën e argumenteve në këtë rast dhe, njëkohësisht, tregon që... (*mungesë audio*), duket që janë të vendosur për ta shembur Teatrin.

Kërkoj edhe një herë bashkëpunimin e deputetëve të maxhorancës, pasi e kam kërkuar edhe një javë më parë në takimin që u organizua në Teatrin Kombëtar. U bëmë thirrje të vinit, në fakt keni pohuar që do të vinit, por nuk erdhët. Kjo është e vërteta! Ministrja pretendohet të vinte, nuk erdhi, madje as sot nuk është e pranishme.

Është një situatë që duhet ta zgjidhim, Albana! Kjo është gjë e përsëritur! Nuk vijnë për shkak të axhendës së ngjeshur, ndërkohë problemet akumulohen, shpërfillen artistët, shpërfilllet komisioni dhe situata bëhet e papranueshme.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Faleminderit, zoti Boçi!

Afërsisht, para një muaji, u kam dërguar një shkresë Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, madje edhe të gjitha ambasadave, ku kam ngritur shqetësimin që ekzekutivi, në shkelje të Kushtetutës, po refuzon të paraqitet në komision, pra, po minohet roli i opozitës.

Në dijeninë time, zoti Ruçi i ka dërguar një shkresë zëvendëskryeministres, zonjës Senida Mesi, ku i kërkon të merren masa që kjo gjë të mos ndodhë më.

Përtej kësaj, unë përsëri do t'i dërgoj edhe një shkresë tjetër Kryetarit të Kuvendit që të marrë përsipër të rregullojë funksionet e parlamentit dhe komisioneve në bazë të Kushtetutës.

Përderisa Kushtetuta dhe ligji nuk vlejnë në këtë shtet, ne do të vazhdojmë të bëjmë punën tonë dhe do të vazhdojmë të presim ministren të paraqitet në komision për t'u përgjigjur për teatrin.

Do t'ju lutesha, për shkak se kemi edhe axhendë tjetër, qoftë në komision, por edhe nëpër partitë përkatëse, diskutimi të jetë i limituar me çështjet kryesore e koncize, në mënyrë që të mundohemi të bëjmë edhe një debat konstruktiv midis njëri-tjetrit.

Faleminderit!

Alert Çeloaliaj - Faleminderit!

Jemi përgatitur seriozisht dhe do të përpiqem të jem konciz. Diskutimi im do të jetë vetëm 4 minuta.

Quhem Alert Çeloaliaj, regjisor, aktor, aktualisht pedagog në Universitetin e Arteve, kryetar i Sindikatës së Artistëve të Skenës dhe Ekranit.

Bashkë me mua janë gjithashtu edhe kolegët e mi, zonja Taulanda Jupi, regjisore dhe pedagoge në Universitetin e Arteve, gjithashtu edhe kolegu tjetër zoti Kastriot Çipi, regjisor.

Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë,

Sindikata e Artistëve të Skenës dhe Ekranit dhe Sindikata e Pavarur e Aktorëve të Teatrit Kombëtar janë të vetmet sindikata të komunitetit teatror në Shqipëri dhe aktualisht përfaqësuese të zërit të këtij komuniteti për problemet emergjente të Teatrit Kombëtar, Teatrit Kombëtar Eksperimental, Cirkut Kombëtar, ligjit “Për artin dhe kulturën” dhe buxhetit të artit dhe të kulturës. Që prej datës 8 shkurt të këtij viti jemi shprehur se ideja për prishjen e Teatrit Kombëtar dhe Teatrit Kombëtar Eksperimental janë të papranueshme, pasqyruar kjo edhe nga peticioni me 90 firma i po kësaj date, 8 shkurt, i komunitetit teatror drejtuar Ministrisë së Kulturës. Në peticion kërkohej debat i hapur dhe publik për këtë temë, por Ministria e Kulturës nuk u ul për debat apo bisedime me komunitetin teatror. Më e keqja, në një letër të hapur të ministres së Kulturës, e cila i drejtohej zotit Ndrenika dhe rrjedhimisht edhe komunitetit teatror, i kujtohet zotit Ndrenika dhe aktorëve se nëse kanë heshtur më parë, nuk kanë më të drejtën e fjalës tani, a thua se demokracia dhe e drejta e fjalës, aq më tepër e një grupi të drejtpërdrejtë interesi, siç janë regjisorët dhe aktorët, është një martesë katolike ku ose flet tani, ose hesht përgjithmonë. Është paradoksale, sepse pas viteve ’91 punonjës ofiçinash, të garazheve dhe të punishteve të pastave si grup i drejtpërdrejtë i interesit i kanë privatizuar ato, ndërsa komunitetit teatror, pavarësisht se është shprehur qartazi pro publikes, sepse teatri është teatër kolektiv dhe publik, i kërkohet të heshtë, duke iu mohuar e drejta e fjalës.

Gjithsesi, duke harruar se komuniteti kishte folur fort në vitin 1998 dhe vitin 2002 për nevojën emergjente për ruajtjen dhe rikonstruksionin e Teatrit Kombëtar, në një moment sinqeriteti letra e ministrit të Kulturës shpreh qartë përgjegjësin për situatën e Teatrit Kombëtar sot.

Albana Vokshi – Më falni, ju lutem me mirëkuptimin tuaj, sepse po kalon live në Partinë Demokratike dhe ne nuk jemi më live dhe zëri juaj nuk dëgjohet. A mund ta ndërpresim mbledhjen vetëm 10 minuta për të kaluar prapë live dhe t’ju japim të drejtën, sepse jemi duke folur kot.

Besoj se do të kem mirëkuptimin tuaj, pasi unë fola edhe me zëvendëskryetaren dhe mos ta shpërdorojmë këtë rast. Meqenëse kjo çështje është shumë e rëndësishme, do të donim ta trajtonim përpara gjithë publikut shqiptar.

Ju lutem, me mirëkuptimin tuaj dhe të nënkryetares, kërkoj vetëm 10 minuta pushim.

Alert Çeloaliaj – Mendoj se shpreh edhe opinionin e kolegëve se do të ishte interesante që ta dëgjonim live.

Albana Vokshi – Po, por nuk jemi live...

Alert Çeloaliaj – A mund ta di se kush është zotëria?

Në hapje të mbledhjes, unë kolegët e mi i prezantova...

(Diskutime pa mikrofon)

Shezai Rrokaj – E para, zonja kryetare, ju duhet të ndërhyni sa herë...

(Diskutime pa mikrofon.)

A mund të flasim edhe ne këtu?

(Diskutime pa mikrofon)

Unë nuk flas sa herë që ka kamera, flas se jam thirrur në komision, madje nuk e di kur transmetohen dhe kur nuk transmetohen, sepse detyra e komisionit nuk është të flasë sa herë që transmetohet në media, kjo nuk ka lidhje, pasi media bën punën e vet.

Ajo që unë doja të thosha ka të bëjë me mbrojtjen e autoritetit të këtij komisioni nga ana juaj, të mos i lejoni të ftuarit e nderuar, të na vënë përballë një përgjegjësie. Ne si komision nuk e kemi institucion të varësisë së drejtpërdrejtë ministren. Ne e thërrasim, por ka edhe rrugë të tjera të ndërmjetme, që ju i keni ndjekur më së mire, kur kreu i një ekzekutivi nuk vjen, por jo të ndihemi fajtor.

Ju ju kemi dëgjuar njëqind here. Në qoftë se nuk duan të dëgjojnë, atëherë kemi punë të tjera me të cilat mund të merremi.

Alert Çeloaliaj – Kjo është arsyeja pse ne jemi sot këtu, sepse ka 27 vjet që pretendon se është kryetar... unë e njoh vetëm si emër, është hera e parë që...

Prej 27 vjetësh pretendon se përfaqëson artistët, zoti Reshat Ibrahim, por unë e shoh për herë të parë fizikisht zotërinë.

(Reshat Ibrahim, kryetar i Sindikatës së Artistëve, largohet për mungesë të Ministres së Kulturës.)

(Diskutime pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Është interesuar, ka pyetur dhe ne i kemi thënë që ditën e hënë në orën 11:00 kemi mbledhje.

(Diskutime pa mikrofon.)

Reshati është në të drejtën e vet dhe kërkon takim me ministren...

(Diskutime pa mikrofon.)

Alert Çeloaliaj – Zonja kryetare, mund t’jua konfirmoj që është takuar me ministren, sepse para 3-4 javësh ka firmosur një kontratë në emër të disa artistëve, të cilët nuk e dinin se kush i përfaqësonte për kontratë kombëtare me ministren...

(Diskutime pa mikrofon.)

Kontratë kolektive pune, pa u konsultuar me komunitetin...

Albana Vokshi – Zotëria ka parë njoftimin se do të jetë e pranishme ministrja dhe ka dashur të jetë i pranishëm...

(Diskutime pa mikrofon.)

Atëherë, duke ju kërkuar ndjesë edhe një herë, po ia kaloj fjalën kryetarit të sindikatës SASE, zotit Aler Çeloalia.

Unë do të kërkoja që ta nisje nga ato dy fjalitë e fillimit, sepse nuk patëm vëmendjen e duhur.

Faleminderit!

Alert Çeloaliaj – Kërkoj ndjesë për zotin Derhemi, i cili është kryetari i Sindikatës së Pavarur të Aktorëve të Teatrit Kombëtar, pasi nuk mundi dot të vinte këtu! Duhej të ishim të katërt prezent.

Sindikata e Artistëve të Skenës dhe Ekranit dhe Sindikata e Pavarur e Aktorëve të Teatrit Kombëtar janë të vetmet sindikata të komitetit teatror në Shqipëri dhe përfaqësuesit e zërit të këtij komuniteti për problemet emergjente të Teatrit Kombëtar Eksperimental, Cirkut Kombëtar, ligjit “Për artin dhe kulturën” dhe buxhetit të artit dhe kulturës.

Që prej datës 8 shkurt të këtij viti jemi shprehur se ideja për prishjen e Teatrit Kombëtar dhe Teatrit Kombëtar Eksperimental është e papranueshme, pasqyruar kjo edhe me një peticion me 90 firma drejtuar ministres së Kulturës, ku kërkohej një debat i hapur dhe publik për këtë temë. Por ministrja e Kulturës ende nuk ka pranuar të japë përgjigje dhe të ulet në debat apo bisedime me komunitetin. Në një letër të hapur ministrja e Kulturës i drejtohet zotit Robert Ndrenika dhe, rrjedhimisht, edhe komunitetit, duke u kujtuar se nëse kanë heshtur më pare, nuk kanë më të drejtë fjale, a thua se demokracia dhe e drejta e fjalës, aq më tepër e një grupi të drejtpërdrejtë interesi, është një martesë katolike, ku ose flet tani ose hesht përgjithmonë. Është paradoksale, sepse pas viteve ’91 punonjës ofiçinash, garazhesh dhe punishtesh pastash, si grup i drejtpërdrejtë interesi, privatizuan ato objekte, ndërsa komunitetit teatror, pavarësisht se është shprehur qartazi pro

publike, pasi teatri është art kolektiv dhe publik, i kërkohet sot të heshtën duke i mohuar edhe e drejta e fjalës. Gjithsesi, duke harruar se komuniteti kishte folur fort në vitet '98 dhe 2002 për nevojën emergjente të ruajtjes dhe rikonstruksionit të Teatrit Kombëtar, në një moment sinqeriteti, letra e ministres së Kulturës shprehte qartë përgjegjësinë e Teatrit Kombëtar sot.

Citoj: “Unë mendoj njësoj si ju me dhimbje se Teatri Kombëtar u la pa investim dhe pa rehabilitim për dekada, derisa degradimi i tij mbërriti në kufijtë e skajshëm, saqë është bërë i parikuperueshëm. Pra, është e qartë se përgjegjëse janë qeveritë, të majta dhe të djathta, të cilat kanë thujse 30 vjet në pushtet”. Çuditërisht këtë e thotë ministri më jetëgjatë i Kulturës në Shqipëri, që, nën epitetin “i parikuperueshëm”, nuk ka ndërmarrë asnjë masë për mirëmbajtjen e Teatrit Kombëtar, duke e shpërfillur edhe raportin e vitit 1999, që merr përsipër rikonstruksionin e Teatrit Kombëtar me një shifër prej 1 milion dollarësh ose 1 miliard e 410 milionë e 280 mijë lekë të vjetër.

Duke parë edhe diferencat aktuale në krah të Teatrit Kombëtar dhe Teatrit Kombëtar Eksperimental, pas mirëmbajtjeve dhe restaurimeve të bëra nga ana e drejtorisë së Teatrit Kombëtar Eksperimental, është e qartë se shifra e mësipërme duhet të jetë një shifër realiste. Më tej ajo që na bën më tepër çudi, si komunitet, është fakti se nuk ka asnjë argument të fuqishëm lidhur me parikuperueshmërinë e teatrit.

Argumentet që jepen janë vetëm fluide dhe pa bosht, mbi të gjitha gjykuar edhe nga parimi i veprimt apo mosveprimt të ekzekutivit, ndoshta edhe penalisht të dënueshme. Thuhet se teatri rrezikohet nga shembja dhe nga zjarri, por, ndërkohë, nuk merret asnjë masë, duke lejuar vënien në rrezik të jetës së spektatorëve dhe të trupës. Nëse nuk ekziston ky rrezik, kjo quhet përhapje paniku. Nëse rreziku ekziston, atëherë pse nuk merren masa?! Por, nuk ka asnjë dokument që të vërtetojë parikuperueshmërinë e teatrit. Më tej, para publikut, prezantohen tituj në italisht, që pretendojnë se teatri ka në përbërje materiale asbesti, duke u cilësuar si shkaku i humbjes së jetës së disa figurave të teatrit, ku, në mënyrë aspak etike, luan me emocionet e të afërmeve dhe kolegëve. Pavarësisht kësaj, askush nuk e shpjegon dot pse ngrihet ky pretendim, kur titulli në fjalë në italisht nuk e përmend asbestin apo kur figura të tjera të teatrit vazhdojnë të jetojnë dhe të gëzojnë shëndet të plotë.

Në radhën e argumenteve shtohet edhe fakti se godina është ndërtuar me material pupurit, duke e lënë qëllimisht jashtë vëmendjes së publikut faktin se sot në shumë teatro të botës ky material përdoret për cilësitë akustike, termike dhe kundër zjarrit.

Këto argumente publike shoqërohen edhe nga veprime që kalojnë në heshtje, siç është heqja e Teatrit Kombëtar nga zona historike e Tiranës, a thua se kriteret që e vendosën atë në hartë, sot nuk qëndrojnë më. Ndoshta patriotizmi i tepruar bën që kjo godinë të sulmohet si godinë fashiste, megjithëse UNESCO nuk vuajti këtë kompleks kur i shpalli godinat e ndërtuara nga Italia fashiste, Eritrea, si trashëgimi botërore. Diferenca qëndron në faktin se qeveria “Eritrea” i kishte mirëmbajtur godinat dhe kjo për Shqipërinë ishte një shans i humbur, sepse Teatri Kombëtar nuk u përfshi as në projektin “Kthim në identitet”, ku u restauruan shumë ndërtesa, gjithashtu fashiste.

Duke u kthyer te problemi i fondeve, çështja për komunitetin teatror bëhet shqetësuese, sepse na është thënë se nuk ka para të mjaftueshme për teatrin, se zgjidhja e vetme është shembja e teatrit dhe se, nëpërmjet partneritetit publik–privat, do të ngrihet një teatër më i vogël, por më modern dhe pjesa tjetër e terrenit do të kompensojë investimet private për ndërtimin e teatrit të ri.

Komuniteti teatror është shprehur kundër kësaj ideje që në vitin 2002, së pari, sepse në këtë periudhë, thuhet 30-vjeçare, do të mund të kishim kursyer aq sa të rikonstruonim një teatër kombëtar.

Së dyti, sepse ekzekutivi dhe ne, si komunitet, nuk i kemi ezauruar të gjitha mënyrat e mbledhjes së fondeve për restaurimin dhe rikonstruksionin e teatrit. Problemi qëndron edhe te mosadministrimi dhe zgjedhja e gabuar e prioriteteve. Për shembull, teatri “Andon Zako Çajupi” nuk ishte në gjendjen e Teatrit Kombëtar, që të kishte nevojë për ndërhyrje emergjente, kurse Teatri Kombëtar po.

Kujtojmë, nga eksperiencat botërore, raste më të rënda se godina e Teatrit Kombëtar, ku me vullnet është bërë rikonstruksioni dhe restaurimi identik me projektet origjinale. Këtu mund të përmendim “Globus-in” në Londër apo “Teatro La Fenice” në Venecia.

Përtej problemeve administrative mosrestaurimi apo shembja e Teatrit Kombëtar, godet trashëgiminë kulturore, trashëgiminë historike, trashëgiminë arkitekturore dhe kujtesën emocionale të kryeqytetit. Ky është një institucion unik, ku u themeluan: Baleti i vogël në vitin 1947; Filarmonia e Shtetit në vitin 1952, që sot është Teatri Kombëtar i Operës dhe Baletit; Cirku Kombëtar në vitin 1952, që sot është i vetmi cirk në Ballkan; Estrada e Shtetit në vitin 1952, që sot është Teatri Metropol; shkolla e lartë e aktorëve “Aleksandër Moisiu” në vitin 1959, që sot është Universiteti i Arteve; si dhe Teatri i Komedisë në vitin 2011, që sot është Teatri Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli”.

Për vlerat që ka për komunitetin teatri dhe kombin shqiptar, shembja e tij dot të ishte e barasvlershme me shembjen e ndërtesës së Mësonjëtores së Parë Shqipe apo me Shtëpinë e Pavarësisë në Vlorë. Të gjithë ata që do të vendosin pro shembjes së Teatrit Kombëtar, duhet të kuptojnë se trashëgimia politike që do të lënë do të jetë e barabartë me atë të shembjes së kishave dhe xhamive në vitet ‘60.

Ftoj zotin Pandeli Majko, i vetmi Kryeministër shqiptar që ka bërë vërtet diçka për teatrin, që ashtu si në vitin 2002, mbështetur nga 65 deputetë të të gjithë spektrit politik, të prononcohet pro ruajtjes dhe restaurimit të Teatrit Kombëtar dhe Teatrit Kombëtar Eksperimental.

Ne e mbështesim idenë e ekzekutivit për një teatër të ri dhe dinjitoz në Tiranë, për sa kohë që ky teatër i ri do të ndërtohet diku tjetër, duke shtuar salla, kapacitete spektatorësh dhe vende pune për të rinjtë; duke respektuar, restauruar dhe duke ruajtur arkitekturën, kujtesën, traditën, historinë, artin dhe vlerësimin për gjigantët shqiptarë të skenës, me simbol godinën aktuale të Teatrit Kombëtar.

E gjitha kjo është lehtësisht e mundshme, duke i shpallur Teatrin Kombëtar dhe Teatrin Kombëtar Eksperimental monumente kulture.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Faleminderit!

Po, zonja Taulanta.

Taulanta Jupi – E nderuar zonja kryetare e komisionit,

Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë,

Shqipëria aktualisht, sipas të dhënave zyrtare, e ka buxhetin vjetor për artin dhe kulturën 16 milionë euro ose 0,7% të buxhetit vjetor të shtetit.

Ministria e Kulturës radhitet e fundit për sa i përket peshës që ka në totalin e shpenzimeve për vitin 2018, pra 0,7% të totalit të buxhetit të shtetit.

Sipas zërave të kësaj ministrie, shpenzimet e saj do të shkojnë për: planifikim, menaxhim dhe administrim, trashëgimi kulturore, muze, art dhe kulturë. Imagjinoni se sa për qind të 0,7%-it përfundojnë për artin dhe kulturën, veçanërisht për teatrin, i cili, më lejoni t’ju kujtoj, është i vetmi art, së bashku me kinematografinë, që i flet botës shqip.

Më lejoni t’ju citoj diçka, që vetë ky komision e ka shkruar në raportin e projektligjit “Për buxhetin e vitit 2018”: “Vëmendje u kushtohet mirëmbajtjes së 2400 objekteve të trashëgimisë kulturore. Gjithashtu, përmes kalendarëve artistikë, ato do t’i kthejnë këto në qendra të hapura dhe

vlera kulturore. Po kështu, në sajë të këtij buxheti, do të ristrukturohen edhe disa objekte të kultit, siç janë kishat dhe xhamitë”.

Shpërndarja në përqindje e zërave të këtij buxheti duket se shterohet magjishëm nga togfjalëshi “trashëgimi kulturore”. Trashëgimia kulturore është dhe duhet të jetë një element krenarie kombëtare për atë që kemi qenë, por kjo nuk duhet të pengojë atë që ne jemi sot dhe sidomos projektimin tonë kulturor dhe social në të ardhmen.

Sipas parimeve demografike të një shoqërie, 27 vjet do të thotë një brez. Unë ju siguroj se në këta 27 vjet përpëlitje, në mungesë të mekanizmave dhe strategjive për teatrin dhe kulturën, shoqëria shqiptare e ka humbur një brez artistësh të skenës dhe ekranit. E gjithë kjo përpjekje që ne bëjmë sot nuk është një përpjekje thjesht dhe vetëm për sot, nuk është një përpjekje thjesht dhe vetëm për të ngritur shpërblimet, nuk është një përpjekje thjesht dhe vetëm për shumë fonde për teatrin, por ka në thelb vendosmërinë për ta ndryshuar këtë realitet përmes propozimeve për hartimin e strategjive në koncepte të reja reale.

Rritja e buxheti për artin dhe kulturën, vendosja e tij të paktën në nivele të krahasueshme me vendet e rajonit, mbetet një nevojë emergjente. Që rritja e buxheti për artin dhe kulturën të jetë efikase, duhet patjetër të jetë e shoqëruar me një ligj për artin dhe kulturën, thelbi i të cilit të jetë krijimi i një strategjie kombëtare, i krijimit të elitës kulturore të vendit, i krijimit të autonomisë së artistëve, pjesëmarrjes së tyre në vendimmarrje, si dhe në përcaktimin e politikave kulturore.

Ligji aktual “Për artin dhe kulturën” është shumë i përgjithshëm, ndaj ai duhet të ndahet në disa ligje të tjera, siç është krijimi i një ligji të veçantë për teatrin, në të cilin të përcaktohen qartë statusi i Teatrit Kombëtar, struktura dhe buxheti i tij, statuset e teatrove të rretheve dhe krijimin e teatrove rajonale, që janë në varësi të pushtetit lokal, ku buxheti i tyre të përcaktohet me anë të një përqindje të përcaktuar të buxheteve lokale dhe jo sipas dëshirës së drejtuesve të pushteteve lokalë, si dhe rikrijimi i Qendrës Kombëtare për Artin Skenik.

Filozofia aktuale e buxhetit për artin dhe kulturën është shpërndarja e tyre në shumë projekte, të cilat realizohen me buxhete shumë të ulëta, duke i lënë artistët në kufijtë e mbijetesës, duke mos krijuar vazhdimësi, duke i nxjerrë ata nga funksioni profesional dhe duke i zbritur në kufijtë e amatorizmit.

Kjo mënyrë shpërndarjeje e buxheteve është e centralizuar, ku të gjitha vendimet për projektet e kulturës merren nga ministri apo nga bordet e vendosura prej tij, përjashton artistët nga vendimmarrja dhe nuk krijon mundësinë e një sistemi të qartë të funksionimit të skenave

menaxheriale në art. Ndaj, një ligj i ri për artin dhe kulturën i riparoi këto defekte dhe është një domosdoshmëri.

Meqenëse sistemet krahasuese përbëjnë gjithmonë thelbin në ndërtimin e strategjive, më lejoni të sjell disa shifra në lidhje me buxhetet për kulturën në vendet e rajonit: Serbia, 3% të buxhetit vjetor ose 112 milionë euro; Maqedonia, 3% të buxhetit vjetor ose 69 milionë euro; Kroacia, 3% të buxheti vjetor ose 117 milionë euro; Mali i Zi, 9,94% të buxhetit vjetor, por këtu përfshihen, përveç artit dhe kulturës, edhe sporti dhe media. Ndaj, ne kërkojmë të paktën barazimin ose krahasimin, në nivele të pranueshme të buxhetit shqiptar për artin dhe kulturën, me vendet e rajonit.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Faleminderit, zonja Taulanda!

Zoti Çipi, fjala për ju.

Ju lutem prezantohuni si fillim, për efekt regjistrimi.

Kastriot Çipi – Unë jam Kastriot Çipi, regjisor dhe anëtar i sindikatës.

Në këta 3 muaj që po flitet për shembjen ose jo të Teatrit Kombëtar, më bën përshtypje se asnjëherë nga përfaqësuesit e pushtetit nuk përmendet Teatri Kombëtar Eksperimental.

Në projektin e paraqitur në televizion nga Kryeministri në datën 12 mars, shihet qartë se nëse ai projekt do të realizohet, atëherë Teatri Kombëtar Eksperimental nuk do të ekzistojë më. Edhe nëse Teatri Kombëtar do të ishte një ndërtesë, siç pretendojnë përfaqësuesit e pushtetit, me rrezik për jetën për shkak të shembjes, deri më sot nuk është thënë asnjë fjalë për Teatrin Kombëtar Eksperimental, që të justifikohet shembja.

Një vizitë e shkurtër në këto dy teatro mund të bëjë çdo njeri të kuptojë diferencën e cilësisë së fasadave që, në fund të fundit, është diferenca e dy qëndrimeve të dy drejtorëve të ndryshëm, ndonëse të emëruar nga e njëjta maxhorancë. Kemi një drejtor që, në mënyrë kokëfortë, për 4 vjet nuk ka paguar asnjë qindarkë investime për mirëmbajtjen e ndërtesës dhe, në krahun tjetër, është një drejtor, i cili, gjithashtu, nuk ka përfutur fonde nga qeveria.

Unë kam korrespondencë me Ministrinë e Kulturës, ku i kam kërkuar informacion për punimet në fasadën dhe në interierët e Teatrit Kombëtar Eksperimental. Përgjigjja që më ka dhënë ministria është se nuk janë fonde publike, nuk i ka prokuruar dhe nuk i ka bërë ajo projektet.

Pra, kur ekziston dëshira e mirë, edhe me pak fonde, sepse unë e kam vështirë të imagjinoj që një drejtor nuk përfiton fonde publike, mund të përfitojë kaq shumë fonde, miliona euro për ta restauruar këtë ndërtesë.

Siç u tha në prezantimin e zoti Çeloaliaj, ka një studim që qeveria vazhdon ta injorojë. Në vitin '99 kostoja e rikonstruksionit të plotë, rrëzimit të mureve në tokë dhe ndërtimi nga e para, jo e restaurimit, është 1 milion dollarë. Qeveria në këta vjet ka pasur në dispozicion 10-fishin e kësaj shume. Qeveria ka pasur 3 miliardë lira të ofruara nga qeveria italiane në vitin '99 për restaurimin e ndërtesave të ndërtuara nga arkitektët italianë para luftës dhe e ka shpërdoruar këtë fond.

Në vitin 2000 ka pasur 2,5 milionë euro grand nga Greqia, i cili duhet të jetë dyfishuar nga interesat bankare të mbajtura prej 15 vjetësh në llogari në bankën e shtetit shqiptar. Në mënyrë shumë të çuditshme vendos që këtë fond ta kalojë për operën, ndërkohë që Teatri Kombëtar vazhdon të jetë në emergjencë, sipas Ministrisë së Kulturës.

Sot e kësaj dite që flasim, nëse shikoni në faqen e internetit të Ministrisë së Kulturës, raportohet si projekt restaurimi i Teatrit Kombëtar, saktësisht në rubrikën e programit për trashëgiminë kulturore. Në programin elektorale 2013-2017 premtohet rikonstruksioni i plotë i Teatrit Kombëtar. Në 4 vjet nuk paguhet asnjë qindarkë. Në muajin prill të vitit 2014, zonja ministre, në shoqërinë e zotit Çuli, drejtor i Teatrit Kombëtar, dhe zonjës Dollani, drejtoreshë e Institutit të Monumenteve të Kulturës, kanë deklaruar në kor se teatri ka rrezik jete. Unë nuk di asnjë rast tjetër që një titullar shtetëror të deklarojë se një ndërtesë publike përmban rrezikshmëri jete dhe nuk e rrethon, nuk e bllokun dhe nuk e restauron atë ndërtesë për 4 vjet. Siç ju thashë, fondet kanë qenë inekzistente. Kam kërkuar informacion dhe nuk më është dhënë. Prej 6 muajsh jam në përpyetje me Komisionerin për të Drejtën e Informimit për të marrë informacion për këtë situatë.

Na kanë thënë se ndërtesa ka asbest, por askush nuk e thotë burimin e informacionit. Burimi që kemi ne është relacioni i firmës “Patri”, që e ka ndërtuar dhe në 15 faqet e tij nuk ekzistojnë fjalët “asbest” apo “amiant”. Na kanë thënë se, sipas specialistëve, ndërtesa rrezikon shembjen. Kam raportet e Institutit të Ndërtimit, i cili është i vetmi ent publik i specializuar dhe i ngarkuar me ligj për vlerësimin e gjendjes teknike të ndërtesave dhe në asnjë rresht nuk ekziston fjala “rrezikshmëri për shembje”. Le ta gjejë një deputet, nëse mundet.

Kam dy raportet e Institutit të Monumenteve të Kulturës dhe nuk flitet për rrezik zjarri apo për rrezik shembjeje.

Meqenëse jam te raporti i Institutit të Monumenteve të Kulturës, duhet të hap një parantezë. Nëse teatri nuk ka qenë monument kulture i mbrojtur deri vitin e kaluar, ç’punë kishte Instituti i Monumenteve të Kulturës të bënte ekspertiza për këtë ndërtesë? Instituti i Monumenteve të Kulturës nuk bën ekspertiza për ndërtesa publike që nuk e kanë këtë status.

Më tej, na është thënë se salla ka qenë “*dopolavoro*”.

Së pari, duhet të sqarojmë se “*dopolavoro*” do të thotë thjesht “pas pune”. Ky term është përdorur nga italianët para dhe gjatë luftës për të përshkruar veprimtaritë që bëheshin jashtë funksionit kryesor të zyrtarit publik apo zyrtarit ushtarak. Na është thënë se nuk është ndërtuar si teatër, por si “*dopolavoro*”, por nuk është absolutisht e vërtetë. Jo vetëm që ka qenë teatër, jo vetëm që ka në fasadë emrin Teatri “Savoia”, por ka pasur sezon lirik nga viti 1940, që do të thotë stinë koncertore, shfaqjesh opera dhe baleti. Kam fotot për shfaqjet e dhëna në atë skenë përgjatë gjithë vitit, madje edhe koncert me këngë dhe valle folklorike shqiptare. Kjo që ju thashë ka ndodhur në vitin 1940.

Ndërkohë, kanë thënë se ndërtesa është bërë për ushtarët italianë. Absolutisht e pavërtetë. “*Dopolavoro*” për ushtarët ka qenë kjo (*tregon fotografinë.*) Këtu duket fare qartë se shkruhet “*Partito fascista albanese dopolavoro delle forze armate*”, “*Klubi pas pune i ushtarëve*”, një ndërtesë njëkatëshe me tjegulla. Edhe një fotografi tjetër “*Dyqani i ushtarit*”, “*Bottega di soldato*”. (*tregon fotografinë.*)

Siç ju thashë, teatri ka qenë i ndërtuar si pjesë e rrethit Skënderbeg. Ja ku është botimi italian, që Ministria e Kulturës dhe zoti Erion Veliaj e tundin mbarë e prapë si burim reference për ekspertizën e gjendjes së Teatrit Kombëtar (*tregon botimin*). Këtu thuhet “*Circolo Skanderbeg*”, siç quhej në të vërtetë.

Deputetët e nderuar duhet ta dinë se ndërtimi ka filluar në vitin ’38 dhe ka mbaruar në janar të vitit ’39, që do të thotë 3 muaj para pushtimit fashist. Mund të më shpjegojë dikush pse qeveria e Zogut që, sigurisht, në vitin ’38 nuk e dinte se do ta linte pushtetin, do të kërkonte një ndërtesë “të përkohshme”, siç thuhet poshtë e lartë? Nuk na japin asnjë referencë se ku është shkruar që kjo ndërtesë është ndërtuar si e përkohshme. Japin edhe afatin madje, 10 apo 15 vjet, por është absolutisht e pavërtetë.

Nëse duam të merremi me termat, opera “*dopolavoro albanese*” quhej salla që është sot Universiteti i Arteve. Nëse duhet të shembim një “*dopolavoro*”, duhet të shembim sallën e

Akademisë së Arteve. Për mua do të ishte një çmenduri edhe më e madhe se të shembej Teatri Kombëtar, sepse është salla me akustikën më të mirë që ka Shqipëria sot e kësaj dite.

Që ta keni të qartë çfarë masacre po i bëhet Tiranës, që ka filluar, ç'është e vërteta, jo me këtë qeveri, jo sivjet, por prej shumë kohësh, duhet të dini se nëse shkatërrohet Teatri Kombëtar, shkatërrohet një stil i veçantë arkitekturor ndërtesash, që sot janë në mbrojtje në të gjithë botën.

Kjo është Kisha Katolike e Tripolit, e ndërtuar nga italianët. Myslimanët e ruajnë si sytë e ballit, është trashëgimi kulturore (*tregon fotografinë*).

Kjo është dega e Bankës Kombëtare Greke në ishullin e Rodos-it, gjithashtu monument kulture (*tregon fotografinë*).

I solla jo më kot këto dy foto, sepse besoj që ju kujtojnë Teatrin Kombëtar, nëse i shikoni.

Grekët ortodoksë, që kanë qenë të pushtuar nga italianët, nuk i urrejnë ndërtesat e italianëve, por i ruajnë.

E fundit, për të mos u zgjatur shumë, kam disa fotografi ndërtesash të ndërtuara në Asmara të Eritre-as, që mund t'ua jap deputetëve. Eritre-a është një vend i varfër që nuk njeh zgjedhje fare, jo zgjedhje të lira. Ata zyrtarisht nuk bëjnë zgjedhje që nga viti 1991, as formalisht, por këto ndërtesa nuk i kanë shembur. Madje, as pushtuesit etiopinë nuk i kanë shembur. Në vitin 2017 UNESCO e ka shpallur trashëgimi botërore, mund ta verifikoni me numrin 1550. E dini cilat ndërtesa ruhen atje? Ruhet edhe një pikë karburanti "Fiat Tagliero". Nuk pyet njeri për çfarë është ndërtuar, i ruajnë të gjitha. Sot janë të gjitha ndërtesat administrative dhe, nëse doni ta dini, argumenti i UNESCO-s për ta shpallur është pikërisht ai që mungon në rastin e Shqipërisë, argument që nuk mund të ndërtohet në rastin e Shqipërisë, sepse flet për ruajtjen më së miri të planit urban dhe të arkitekturës.

Në momentin që ne kemi ndërtuar dy kulla dhe kemi vazhduar të bëjmë masakrat tona urbane, e kemi humbur këtë status, por çështja është të ruajmë atë që ka mbetur.

E fundit, ish-Kombinati i Tekstileve "Stalin" në Tiranë për mua është një gërmadhë, besoj se këtë mendim e ndaj edhe me shumë njerëz të tjerë. Mund të jetë edhe i rrezikshëm, sepse ka 25 vjet që atje nuk punohet. Kjo qeveri e ka shpallur monument kulture. Sipas meje, ka bërë shumë mirë, por a nuk duhet, me të njëjtën logjikë, të shpallet monument kulture Teatri Kombëtar?

Këto kisha. Jam në dispozicion të deputetëve për çdo pyetje.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Faleminderit për prezantimet, që ishin koncize!

Unë do të doja të na linit një kopje të fotove dhe të prezantimeve tuaja, nëse keni.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Për procedurë?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Për diskutim?

E kërkoi fjalën Fideli.

Fidel Ylli – Unë e dëgjova me vëmendje referimin e zotërinjve në panel, të cilët përfaqësojnë sindikatën. Mund të jem pjesërisht dakord me ta për transparencën që duhet të ketë qeveria për Teatrin Kombëtar, por edhe unë kam një dosje, pasi kryetarja e komisionit ka kërkuar nga ministria, në bazë të kërkesës që i keni bërë ju, të japë shpjegim për situatën e Teatrit Kombëtar.

Me shumë përgjegjshmëri do t'ju them që për Teatrin Kombëtar ka qenë një kërkesë e ofruar nga biznesi, nuk është ofruar nga bashkia apo nga qeveria. Një firmë, që ka tokën dhe zyrat mbrapa teatrit, ka ofruar një projekt, ku merr përsipër që në pjesën e teatrit të bëjë një teatër bashkëkohor, që shkon rreth 20 milionë euro. Këtë kërkesë ia ka bërë Bashkisë së Tiranës, e cila ia ka dërguar qeverisë, sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, ku po shqyrtohet mundësia të ulen me firmën për këtë ofertë, cilat janë anët ligjore që do të negociohen, për çfarë do të negociohet, cilat janë përfitimet e qeverisë apo të firmës në këtë rast për të konkluduar në rast se do të ulen për të biseduar. Është vetëm një ofertë. Nga qeveria po shqyrtohet nëse do të ulen për të diskutuar me firmën apo jo dhe nuk kam asnjë vendim të tillë.

Për sa i përket Teatrit Kombëtar, ashtu si ju, zoti Çipi, edhe unë kam dosjen time, që institutet e specializuara për të dhënë verdiktin e tyre për këtë ndërtesë, janë skandaloze. Nuk po tregoj çfarë kanë thënë, për të mos u ngrënë kohën deputetëve, por janë argumente të inxhinierëve, të konstruktorëve që merren me ndërtime, me këto ndërtesa të hershme, të cilët kanë dhënë mendimet e tyre, që aty vetëm teatër nuk mund të vazhdojë të bëhet. Nuk po u hyj detajeve nëse do të bjerë zjarr sot apo do të bjerë nesër. Mendoj se Shqipëria dhe aktorët e mrekullueshëm që kanë dalë ndër vite kanë nevojë për një Teatër të ri Kombëtar.

Kur është diskutuar për stadiumin kombëtar, kam qenë dakord që shteti ka për detyrë të bëjë një stadium kombëtar, mundësisht pa kullë, larg Tiranës, ta ndërtojë të gjithë vetë, por dalim në konkluzion dhe themi: a ka ky shtet 200 milionë euro për të bërë një stadium? Nëse do të bësh stadium, do të bësh parkim, do t'i çosh trenin, tramvajin, që ky stadium të jetë si të gjitha stadiumet

në botë. Atëherë ka forma, që i ka gjithë bota, si partneriteti publik - privat, ku qeveria vë tokën në dispozicion dhe biznesi hedh 100 milionë euro apo më shumë për të bërë një stadium. Unë kam nxjerrë edhe argumente të tjera për stadiumin, por po them edhe për teatrin.

Mua më prek teatri, sepse kam familjarë që kanë qenë në Teatrin Kombëtar, kanë performuar në ato vite, por mendoj të mos e politizoni. Ju keni të gjitha të drejtat e kësaj bote për të dalë, për të bërë greva, demonstrata, për të kërkuar një transparencë më të madhe të qeverisë. Unë mund të them se, kur ka qenë Bujar Leskaj ministër Kulture dhe kur është hedhur i gjithë ansambli i ministrive, pse nuk është kërkuar që Teatri Kombëtar të futet si trashëgimi kulturore, që të mos preket, siç u fut stadiumi dhe ministritë, por...

(Diskutime pa mikrofon.)

Pjesa e stadiumit, që është monument kulture, do të integrohet në stadiumin e ri. Gurët e asaj tribune të mrekullueshme, kurse pjesa e tribunës ka qenë shumë e rrënuar dhe duhej prishur. Kjo hap debat dhe ju do ta shikoni se si do të inkludohet stadiumi vitin tjetër bashkë me pjesën e trashëgimisë.

Kthehem tek teatri. Mendoni se ai teatër duhet të rrijë gjërmadhë në mes të Tiranës? A e kuptoni se kjo qeveri ka bërë 4 teatro në këta 4 vjet, që nuk janë bërë në 27 vjet? Teatri i Korçës. Shkoni shikojeni! Teatri i Shkodrës, Teatri “Turbina”, Teatri Eksperimental. Jam dakord, kur do të bëhet i riu, pse u hodhën para këtu? Të diskutojmë për këtë pjesë, por unë mendoj që teatri duhet të shembet një orë e më parë dhe ministrja, detyrimisht, duhet të vijë këtu të na japë llogari dhe të na informojë për truallin, për bashkëpunimin me partneritetin publik privat, që gjërat të jenë transparente, sepse është një aset publik. Format e partneritetit publik privat nuk i kemi shpikur ne, por i kemi marrë në botë. Format e stadimeve me kulla, që ua kam nxjerrë në televizor, janë në të gjithë botën, të cilat nuk janë për të ndihmuar biznesin, por janë edhe për çështje të arkitekturës, sepse në kohën kur ishte qeveria “Berisha”, bëri një tender për stadiumin, ku erdhën 5 firmat më të mëdha në botë dhe asnjë nuk e mori përsipër ta bënte dhe të hidhte 200 milionë euro, por ndërruan disa terma, përsëri u bë një tender i hapur dhe fitoi një firmë shqiptare. Unë e kam thënë, edhe miliona lekë të kisha, nuk do të hidhja asnjë lek me këto qeveri të çmendura që e sulmojnë biznesin kaq ashpër, për të bërë ndërtime të partneritetit publik privat, kjo është çmenduri. Ky stadium që do të bëhet, do të jetë më i miri në Europë, pastaj, po t’i hyjmë analizës, nxjerrim edhe fakte dhe shohim se sa metra kanë qenë në kohën e Saliut dhe sa metra janë tani. Është turp, sepse ne duhet ta stimulojmë biznesin, nuk mund t’i kërkojmë dot çdo gjë qeverisë.

Jam dakord që qeveria duhet të mbajë përgjegjësi për të bërë një teatër 50 milionë euro, sepse është vlerë. Aktorët e mrekullueshëm që ne kemi, nuk duhet të marrin rrugët e Europës dhe të ikin. Kjo është një formë bashkëpunimi, pasi transparenca është gjë tjetër dhe unë ju falënderoj që keni ardhur dhe që ngrini zërin, sepse, po nuk ngritët zërin, të gjitha qeveritë të shkelin me këmbë. Por të jeni të sigurt që ministrja do të vijë në komision dhe do të na informojë, ashtu siç na ka sjellë informacionet e duhura për transparencën, se çfarë është bërë deri tani dhe çfarë kontaktesh janë marrë, por nuk ka asnjë vendim të qeverisë nëse do të shembet ose jo teatri dhe këtë jua them me përgjegjshmëri të plotë. Ka një ofertë nga firma dhe po diskutohet për termat juridikë, që të diskutojmë se ku do të tolerojmë dhe ku do të përfitojmë. Unë mendoj që transparenca duhet.

Alert Çeloaliaj – Për sa i përket politizimit, edhe në përmbledhjen tonë ne e kishim të shprehur qartë se pasojat e Teatrit Kombëtar sot, janë pasojat e 27 vjetëve politikë e të majtës dhe të djathtës. Ne jemi para këtij komisioni, në prani të të dyja palëve të deputetëve, edhe të opozitës, edhe të pozitës, dhe nuk kemi ndër mend ta politizojmë këtë çështje. Teatri Kombëtar është jashtë politikës. Ne jemi këtu për godinën e e tij dhe në asnjë rast nuk kemi folur për çështjen e biznesit apo për emra të përveçëm të biznesit, por kemi folur gjithmonë për rikonstruksionin e godinës së Teatrit Kombëtar, madje në fund të fjalës sime u shpreha qartë se jemi pro idesë së ekzekutivit për një teatër të ri dinjitoz dhe modern, por jo mbi kockat e Teatrit Kombëtar.

Për sa i përket çështjes së sigurisë dhe dosjes që ministrja nuk na e vë në dispozicion, pavarësisht kërkesave që i kemi bërë, dua t'ju kujtoj të gjithëve se të shtunën dhe të dielën në sallën e Teatrit Kombëtar Eksperimental janë tri shfaqje fëmijësh, ku mbi 600 fëmijë rrezikojnë jetën në këtë godinë dhe askush nuk bën asgjë. Kjo mua më duket e papranueshme.

Për sa i përket çështjes së ngritjes së teatrove, e përmenda edhe pak më parë se prioritetet që kanë zgjedhur si qeveri, janë të gabuara. Teatri i Korçës nuk ishte në gjendjen apo i rrënuar, siç është lënë Teatri Kombëtar në 30 vjet. As ndërtesa e Teatrit Kombëtar të Operës dhe Baleti nuk ka qenë aq e rëndësishme për të ndërhyrë sesa ka qenë e nevojshme ndërhyrja në godinën e Teatrit Kombëtar.

Ne jemi këtu për të thënë edhe një herë se prioritetet e ministres së Kulturës janë shumë të dyshimta.

Albana Vokshi – Fjalën e ka profesori, sepse do të lëvizë.

Shezai Rrokaj – Faleminderit!

Gjëja që nuk duhet të bëjmë këtu është që ta konsiderojmë Teatrin Kombëtar si pronë të sindikatës dhe artistëve, pasi unë mendoj se kjo është pronë publike dhe është kujtesë. Nëse ne do të shkojmë në çdo vend, në çdo shtet apo në çdo komb, do të konstatojmë që çdo vend ka një teatër kombëtar, ka një stadium kombëtar, ka një muze kombëtar, ka një bibliotekë kombëtare dhe ka një bankë kombëtare, ku shteti ka ndërtuar fytyrën e vet mbi konfiguracionin që marrin këto elemente shumë të qenësishme, që janë ashti i tij.

Problemi i dytë ka të bëjë me ndryshimet ligjore që i janë bërë ligjit të vitit 1994 dhe VKM-ve, përkatësisht VKM-së nr. 180 të vitit 2000 dhe ndryshimi i fundit, VKM-së nr. 325 i muajit prill të vitit 2017.

Nëse shtrojmë pyetjen a duhet një teatër kombëtar i ri aty ku është, unë besoj se përgjigjja ime dhe e publikut është po, sepse nuk mund të rrezikojmë në një teatër që është duke u shembur. Pyetjes se cili do të jetë teatri kombëtar, unë them se beteja këtu është se çfarë imazhi do të ketë ky teatër, ku një pjesë e mirë e shoqërisë është dakord që të mos e fshijmë kujtesën dhe unë do t'jua them pse kjo është e nevojshme, sepse godina ku është bërë Kongresi i Manastirit është një godinë e lënë pas dore, por vlera që ajo ka nuk është nga godina, por nga historia. Edhe Teatri Kombëtar nuk e ka vlerën nga çfarë përfaqëson si çmim ajo ngrehinë, por e ka vlerën nga ajo çfarë përfaqëson për kujtesën historike të vendit.

Unë e pashë skicidenë dhe i bashkohem idesë që tha Fideli, që nuk ka një projekt, por të marrim skicidenë që u paraqit. Fidel, po jua them në mënyrë shumë shoqërore, në qoftë se do të ndërtohet kjo skicide, e cila do të kthehet në një projekt, do të themi që do të shkojmë te Teatri Kombëtar apo do të themi që do të shkojmë te qendra polifunksionale? Po ju drejtohem shumë miqësisht, mos më keqkuptoni.

Fidel Ylli – Do të jetë teatër pa kullë, do të jetë vetëm për teatrin dhe do të ketë 2-3 salla.

Shezai Rrokaj – Kam dy gjëra të rëndësishme për opinionin publik.

Së pari, do të ketë teatër kombëtar që do të konfigurojë, do të ristrukturojë apo do të ndërtojë këtë që shembet, apo do të ketë një teatër kombëtar, i cili vjen si pasojë e një marrëdhënieje me autoritetin publik privat? Ne e dimë që të gjitha marrëdhëniet e partneritetit publik privat ndërtojnë kërraba ose tërhiqen nga vetja.

(Ndërhyrje pa mikrofoni.)

Sigurisht, por ne nuk duam që ai të fitojë në kurriz të Teatrit Kombëtar. Ky teatër i ri kombëtar e ruan apo jo atë që u quajt Ansambël i Trashëgimisë Kulturore dhe duhet shpallur apo

jo pjesë e kujtesës? Unë i përkas fushës së shkencave shoqërore, por them që do të jetë një gafë e madhe, nëse ky teatër nuk do të rindërtohet në imazhin që ka.

Së dyti, nuk do të kisha pranuar kurrë, edhe pse marrëdhëniet mund të bëhen me sipërmarrës privatë, që ai të jetë si një shpërblim i faktit se sipërmarrësi privat (*mungesë dëgjimi*) ...në atë që ai pretendon se është toka e tij. Sigurisht që është toka e tij, por ne e dimë shumë mirë që për interes të publikut tokat mbahen dhe mund të mos jepen (*mungesë dëgjimi*)... për kujtesën e këtij vendi, për një bankë kombëtare, për një stadium kombëtar, për një muze kombëtar dhe për një opera kombëtare. Të gjitha këto janë fytyra historike të një shteti dhe, në qoftë se një vendi do t'i heqim imazhin e ndërtimit, ne i kemi hequr ashtën. Ky është problemi kryesor. Problemi nuk është bashkëpunimi me një partneritet publik privat, por, në qoftë se shteti për 27 vjet ka përdorur shprehjen “S’kemi para për të ndërtuar një teatër”, unë them që kjo është alibi dhe nuk duhet përdorur si argument. Shqiptarët meritojnë të kenë një teatër kombëtar, jo si koncesion i asaj që i kemi dhënë një sipërmarrësi, i cili ka të drejtat e tij dhe këtu ne nuk kemi punë me të, por ne kemi punë me ruajtjen e atij që quhet identitet, sepse identitetin kombëtar e ruajnë pikat e referimit. Kongresi i Manastirit, ajo godinë nuk vlen as 30 mijë euro, por vlera që ka për shqiptarët është pa çmim. Edhe ky teatër mbase si godinë nuk vlen fare dhe patjetër duhet prishur, por ama imazhi dhe kujtesa që përbën për shqiptarët nuk ka çmim. Krijimtaria e studiuesve nuk ka çmim dhe nuk është siç u hodh ndonjë ide e atyre, pasuri e vetme. Imazhi është pasuri kombëtare dhe ne për këtë duhet të insistojmë maksimalisht. Le të bëhet një teatër modern andej nga po zhvillohet Tirana, kurse këtu le të ngelet ky ansambël. Kjo është ideja dhe të mos i jepet një sipërmarrësi thjesht dhe vetëm se ne nuk kemi lekë. Ne mund të jemi shumë të varfër, por jo deri këtu, sepse duket sikur po i lutemi: ama na i bëni këtë, sepse nuk kemi çfarë të bëjmë. Jo, edhe ne kemi një fytyrë shteti, që duhet ta mbrojë këtë gjë.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Faleminderit!

Profesor thuhet se nuk ka para në buxhetin e shtetit për ta rindërtuar, por, në fakt, nuk ka asnjë studim. Qeveria nuk e ka bërë një studim fizibiliteti për të parë nëse duhet shkatërruar, duhet ndërtuar, duhet rikonstruktuar. Pra, ne po flasim apriori për diçka që qeveria nuk ka dashur kurrë që ta bëjë studim, sepse nuk i ka interesuar që ta bëjë këtë studim. Nuk po e them unë si Albana, por është në përgjigjen zyrtare që ka ardhur nga Ministria e Kulturës. Nuk ka studim fizibiliteti për

teatrin, nuk ka pasur asnjëherë, sepse e kemi thënë, e kanë thënë dhe e dinë të gjithë, ky është projekt 20-vjeçar i Edi Ramës për ta shkatërruar teatrin dhe për të ngritur këtu këto kulla.

Së dyti, deri në 2 milionë, edhe me rritjen e çmimeve, a keni ju një studim për ristrukturimin, rikonstruksionin e godinës? Para disa vjetësh ka qenë 1 milionë, kurse tani ka shkuar 2 milionë bashkë me inflacionin dhe me të gjitha. Ministria tha se nuk e ka fare këtë, pavarësisht se ekziston në... Ja kam dhënë edhe unë, por nuk do që ta shikojë. Në fakt, ne jemi këtu, sepse kërkuam që të ishin edhe deputetët e Partisë Socialiste, por të mos krijojmë alibi pa lidhje, që nuk ka lekë buxheti, kur nuk dihet sa do të kushtojë. Thuhet nuk ka lekë nëse bëhet një studim dhe themi nuk kemi kaq lekë. Do të futemi në partneritet?! Hajde, futemi në partneritet.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pikërisht, buxheti është 0,4%.

Kryeministri ka thënë: “Nuk ka buxhet, prandaj do t’ia japim privatit”. Sa është buxheti që duhet për ta rindërtuar? Ju nuk keni studim për këtë, se gjërat bëhen zyrtarisht, bëhen me inicim të një studimi fizibiliteti, ku të nxirret se duhet shkatërruar, sepse nuk bën, duhet rikonstruktuar, sepse bën e të tjera. Pra, të mos flasim apriori, sepse ju po krijoni alibira që nuk funksionon si ndërtesë. Një herë thoni se ka asbest, një herë thoni se është me pupurit e të tjerë, kur të gjitha studimet flasin të kundërtën

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Asnjëri prej ekspertëve nuk ka thënë të shkatërrohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të lutem, Fidel përgjigju një pyetjeje...

Fidel Ylli – Është jashtë funksionit.

Albana Vokshi – Është jashtë funksionit ndërtimi?

Fidel Ylli – Po.

Albana Vokshi – Në rregull, ta marrim se është jashtë funksionit. Atëherë a duhet çuar ministrja para drejtësisë, sepse po shpërdoron detyrën dhe nuk po mbron të gjithë qytetarët dhe artistët, që po shkojnë prej kaq vjetësh në atë ndërtesë? Cili është roli i ministrisë?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Tani ose nuk duhet dhe duhet shembur, dhe hajdeni na jepni studimin, ose duhet dhe hajdeni ta rikonstruktujmë. Pra, kjo është thjesht alibi, që nuk qëndron. Ja ku i ke edhe deklaratat e Shoqatës së Arkitektëve, kanë thënë: “Jo, godina nuk duhet prishur”.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të gjitha forumet dhe të gjitha sindikatat.

Pse është jashtë funksionit godina?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në vendimin e Bujar Leskajt, numrin 2 e ke stadiumin kombëtar, ja ku e ke.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Stadiumi kombëtar “Qemal Stafa” me firmën e Bujar Leskajt, nuk lejohet asnjë ndërtim.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ja ku e keni stadiumin kombëtar, por për ju nuk vlen as VKM-ja, nuk vlen as ligji, nuk vlen asgjë. Pse i doni?! Shkatërroni historinë, shkatërroni kujtesën për të ngritur kulla, që pastrojnë paratë e drogës! Kjo është e tmerrshme!

Urdhëroni, zoti Boçi!

Luçiano Boçi – Së pari, dua të falënderoj artistët për qëndresën e tyre, sepse, në sajë të kësaj qëndrese sot kemi ende gjallë një debat për Teatrin Kombëtar, përndryshe nuk e di çfarë do të kishte ndodhur. Janë përfaqësuesit e artistëve dhe të sindikatave, të cilët nuk janë në emrin e tyre personal, por përfaqësojnë të gjithë artistët.

Sigurisht, në sajë të tyre, pasi e dimë si ka vepruar qeveria, sipas parimit tërhiqë mos e këput, me parimin e lodhjes, pasi ka 3 muaj kjo situatë, me deklaratat dhe kundërdeklaratat, ministrja, në përgjigjen që i ka kthyer komisionit, është shprehur se nuk ka studim fizibiliteti për teatrin. Ndërkohë Kryeministri në fjalën e tij, megjithëse Fideli deklaroi se nuk ka projekt dhe nuk ka një deklaratë që do të shembet, në të gjitha deklaratat publike ka deklaruar se teatri do të shembet dhe do të realizohet projekti i paraqitur nga ai.

Fidel Ylli – Ka një dëshirë politikisht që të kemi teatër kombëtar të ri, këtë ka thënë Kryeministri.

Luçiano Boçi – Dëshirat politike Kryeministri t’i shprehë brenda familjes së tij politike.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në qoftë se ai flet për teatër...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ka 3 muaj që Kryeministri bën teatrin dhe nuk po bëjmë ne teatër, por po bënë Kryeministri dhe ministrja, por edhe ju po i vini pas avazit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Të lutem, Fidel, mos ndërhy!

Luçiano Boçi – Nuk mund të ndërhyjni, sepse unë nuk ju ndërhyra fare.

Kryeministri deklaroi ndryshe, ministrja ndryshe, kryetari i bashkisë ndryshe dhe të gjitha këto janë për të lodhur artistët, që kanë 3 muaj, dhe më pas për të vazhduar me qëllimin e tyre. Argumentet që sillen këtu janë absurde. Kur dëgjoj se do të bëjmë një teatër më të bukur se ai, sikurse bëmë stadiumin më të bukur, tronditem. Ngatërrohet bukuria si kategori estetike e ndërtesave të caktuara, me konceptin e bukurisë kulturore dhe historike, nuk janë e njëjta gjë. Ka të bëjë me identitetin kombëtar ajo bukuria historike dhe kulturore, dhe atë duam të mbrojmë ne, pavarësisht si na i koncepton syri ynë estetik ndërtesën, që do të jetë më e bukura në Europë apo stadiumi më i bukur në Europë. Jo, vlerat historike-kulturore, që përmbajnë ndërtesat e caktuara, janë të patjetërsueshme. Në qoftë se sot do të ishte ministrja e Kulturës, sikurse edhe Kryeministri, me argumentet që sollën sot përfaqësuesit e artistëve, do të bindeshin qartazi. Argumentet ishin të pakundërshtueshme për vlerat historike që kanë godinat dhe mënyrën e sjelljes ndaj vlerave historike. Kjo histori nuk ka dalë rastësisht, historinë e kemi trajtuar, është nga viti 99, 2002-shi, tani dhe gjithmonë personazhi që shfaqet në këtë histori është Kryeministri Rama, sepse dëshira e tij për kullat ka qenë e hershme, nuk dolën tani kullat.

Nuk është si qëllim të bëjmë teatër. Jo! Qëllimi i Kryeministrit është të bëjë kullat dhe me atë rast po pjele edhe një teatër, sipas një sipërfaqeje, duke grabitur edhe pronën publike. Kjo është e vërteta e kësaj historie kaq të gjatë, gati 20-vjeçare, që sot sillet në këtë komision që ne të shprehemi bashkërisht për mbrojtjen e vlerës publike, pasi një nga meritat kryesore të artistëve, për të cilën unë do ta kundërshtoja Fidelin, është se çështjen nuk e kanë politizuar. Sigurisht, bashkohem me profesorin që tha se çështja është publike, ne do të shprehim opinionet tona, kemi bërë edhe qëndresën tonë, kemi kërkuar seanca dëgjimore në vazhdimësi, kemi mbështetur edhe artistët, të cilët, vetëm pas 3 muajsh, pranuan që ne, si politikanë, të shkelim në teatër për një çështje që është krejtësisht publike. Jam dakord, nuk është vetëm e artistëve, por ata e kanë mbrojtur në mënyrë konsekuente dhe për këtë duhen falënderuar! Kjo është krejtësisht meritë e tyre, sepse të ishte për këtë qeverisje, teatri sot do të ishte rrafshuar. Ne jemi këtu për ta mbrojtur. Thashë historia nuk ka filluar këtu, ka filluar shumë më herët, por ka marrë formë ligjore në VKM-në me nr. 325, e cila u përmend këtu, e cila ishte kërkesë e Ministres aktuale të Kulturës, që e nxirrte teatrin nga zona historike e Tiranës dhe e fuste te zona e mbrojtur.

Pati një debat: a ishte monument kulture, apo jo? Ishte pjesë e Ansamblit Kulturor me ligjin aktual “Për trashëgiminë kulturore” dhe nuk lejohej asnjë ndërhyrje, as aty dhe as te stadiumi, pavarësisht se mund të thoni është shumë i bukur, nuk e kundërshtoj fare. Thashë vlera historike është me e bukur, më shumë se çdo estetikë tjetër, që mund të bëhet në këtë vend. Kjo VKM, me nr. 325, e nxjerr me qëllim jashtë zonës historike pjesën e teatrit. Madje aty ka edhe ndërtesa të tjera. Njëkohësisht, në VKM-në me nr. 325, përcaktohet qartazi: “Ndërtesat që mund të rikonstruktohen, jo të ndërtohen, duhet të jenë në harmoni me ansamblin e ndërtesave të tjera.” Çfarë harmonie ka ndërtesa, projektidea me ansamblin e ministrive, që kanë stilin italian të viteve ’38-’39? Asnjë lloj harmonie. Për më tepër, pranohet të shkelet edhe vetë VKM-ja e hartuar nga ministrja dhe Kryeministri me atë projektidenë. Më pas është tronditës argumenti: pse ka një biznes këtu dhe meqenëse ka një zyrë të vogël ai, 500 metra, i duhen edhe 3500 metra; meqenëse ka futur këmbën ai, po shtrihet barkas tek territori i teatrit dhe e do për vete, sepse është territor publik. Ky argument mua më duket absurd. Pra, meqenëse unë jam afër një zone historike, mund të bëj një kullë, të marr edhe zonën historike dhe të bëj një ndërtesë që ndërpret historinë, por që është shumë e bukur dhe publiku e pëlqen! Këtu nuk po flasim thjesht për shije globale, por po flasim për vlera të caktuara që mbrohen sot, sepse kemi një emërues të përbashkët dhe duhet të jemi të ndërgjegjshëm. Të dyja palët këtu thonë se duhet një teatër i ri. Edhe artistët e duan teatrin e ri. Jam dakord që nuk ka kushte dhe që nuk është vënë dorë në atë teatër, por artistët e kërkojnë fare qartë: ai teatër duhet të rikonstruktohet jo në vlerën 2 milionë euro, por 10 milionë euro. Nuk ka fuqi buxheti i shtetit?! E kanë gjetur zgjidhjen...

Unë në fund kam edhe një pyetje për artistët. Ata do të hapin një llogari rrjedhëse, ku të gjithë shqiptarët mund të kontribuojnë për ndërtimin e teatrit, siç është rasti i “Globus”-it, se ma ka shpjeguar Kaçi, apo edhe raste të tjera, ku është ndërhyrë dhe është ruajtur. Dikush solli shembullin e teatrit “Bolshoi” në Moskë se si është rikonstruktuar, pra ishte djegur tri herë, por përsëri ishte kthyer në identitetin e tij. Çështja është kjo?! Në qoftë se qeveria ka vërtet dëshirë ta bëjë ndërtimin edhe me partneritet publik-privat, në rregull, le t’i gjejë një tokë publike diku në Tiranë atij privatit që do të bëjë teatrin, se vlera e tokës në Tiranë dhe në periferi është e lartë, dhe ai ta rikonstruktojë teatrin komplet në sipërfaqen ekzistuese. Pse nuk gjendet ky emërues?! Sepse janë interesat e klientelës; është ëndrra e shtatë kullave. Si mund të jetë i bukur një teatër i rrethuar me shtatë kulla?! Unë këtë nuk e kuptoj dot. Nuk mund të jetë i bukur se as diell nuk ka, sepse edhe diellin do t’ia marrin kullat. Të themi atë që është, jo duke e parë nga sipër se sa e bukur është

si projektide. Ne duhet të mbrojmë vlerat historike, identitetin tonë kombëtar, i cili shprehet në arkitekturë, ku edhe është e gjithë historia. Nuk është thjesht se ku do të ikim, pra te qendra multifunkionale apo tek teatri, por fakti që Teatri është një godinë me vlera të patjetërsueshme.

U shemb stadiumi... Nuk po u hyj fare atyre gjërave, se na i sillni si shembull. Është shkelur qendra historike, është shkelur ligji me të dyja këmbët. Unë habitem si nuk ka procedim penal nga prokuroria për ministrinë përkatëse, qoftë edhe për Kryeministrin! E thotë ligji se nuk bëhet asnjë lloj ndërtimi. Ndërkohë, bëhet ndërtimi për një arsye të pajustificueshme. Gjithsesi, nuk dua të merrem me këtë pjesë, se zhvendoset edhe vëmendja. Ne jemi këtu për teatrin. Ne sot si komision, si politikë përsëritim aktin e vitit 2002, që e vendosi teatrin në “ansamblin kulturor”. Pavarësisht se nuk ishte monument kulture, konsiderohej i tillë. Kastrioti e shpjegoi shumë mirë pse ishte pjesë e “ansamblit kulturor”. Ne, të gjithë, duhet t’i mbështesim artistët pa dallim politik, siç u bë në atë kohë. Ta firmosim, ndoshta siç e ka bërë dikur Musai, dhe të gjithë të jemi në krah të artistëve, që kjo vlerë e ndërtesës historike të mos humbasë. Vërtet jemi një komb me histori shumë të pasur, por shenjat konkrete, të prekshme të kësaj historie të madhe i kemi shumë të rralla, në raport me vendet e tjera. Ne kemi tendencën t’i shkatërrojmë, por kështu shkatërrojmë vetveten dhe historinë tonë.

Pyetja që kisha unë për artistët është... Ata kanë marrë iniciativën për të hapur numrin e llogarisë, në fakt unë do t’i nxis që ta hapin sa më shpejt, sepse në qoftë se e lënë pa hupur, qeveria do të vazhdojë me projektin e PPP-së. Rama e ka shprehur në të gjitha situatat: “Do të shembet, do të shembet...” Ne duhet ta ndërpresim me të gjitha format dhe mënyrat. Një nga format dhe mënyrat është hapja e asaj llogarie, ku të gjithë shqiptarët të kontribuojnë për ngritjen e një teatri kombëtar.

Ju faleminderit!

Fidel Ylli – Unë desha t’i bëj vetëm një pyetje zotit Boçi.

Albana Vokshi – Fidel, të lutem, mos e merr fjalën, se ta jap unë! Janë disa procedura.

Fidel Ylli – Të kërkoj ndjesë! Që të mos kalonim në debate të tjera, dua t’i bëj vetëm një pyetje, për procedurë: pse ngrini zërin dhe ju djeg shpirti për të hapur një numër llogarie për Teatrin kur në kohën e zotit Pango qeveria “Berisha” nxori 3 milionë dollarë dhe tha se do të bënte teatrin e ri te Piramida?! U nxorën 3 milionë dollarë dhe e dini shumë mirë se kush e fitoi tenderin, por doli një ditë të bukur dhe tha: “Nuk do ta bëjmë teatrin, por do ta prishim dhe do të bëjmë parlamentin”. A e kuptoni se ku jeni dhe se çfarë thoni? I gëlltisni ato që keni thënë dhe vini sot e

qani, po bëni si Kadri Roshi këtu që aktronte aq bukur. 3 milionë dollarë i nxori qeveria, ku vajtën lekët e taksapaguesve?

Albana Vokshi – Fidel, ose bëj pyetje, ose bëj diskutim.

Fidel Ylli – Pyetje retorike ishte.

Albana Vokshi – Nuk ka nevojë të marrësh flamurin sot.

Luçiano Boçi – Meqenëse e kishe pyetjen retorike, po ta jap përgjigjen me pyetje retorike. Pse ju desh ratë theror për Piramidën, të cilën e konsideronit objekt me rëndësi historike, kur e dinit vitin e ndërtimit, që nuk ka aq vjet sa ka Teatri dhe sot heshtni të gjithë? A mbani mend zhurmën që bëtë?! Ishit gati të thyenit parlamentin për atë ndërtesën atje, që ka vlerat e saj nga ana e arkitekturës, sigurisht. Keni bërë namin...

Fidel Ylli – Ku vajtën 3 milionë euro?

Luçiano Boçi – Ishte retorike kjo...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ku ikën lekët?! Janë rialokuar. Mos hidh hipoteza! Lekët që erdhën nga qeveria greke ku vajtën, që i kishte Rama kur ka qenë ministër? Ku i çoi Rama 5 milionë eurot që erdhën nga qeveria greke për rikonstruksion?

(Fidel Ylli ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, tani, por atëherë kur ishte ministër. Ku i çoi Rama 5 milionë euro?

Albana Vokshi – Fidel, nëse ju djeg zemra dhe shpirti, flisnit për stadiumin kombëtar.

Luçiano Boçi – Po atë pjesën që e dha me qira, që e shkurtoi sipërfaqen dhe futi në xhep 100 mijë euro kur ishte ministër Kulture, pse nuk e thoni ju këtu? Është denoncuar në të gjitha mediet e kohës kontrata e qirasë që bëri Kryeministri aktual në atë kohë, pra fshehu sipërfaqen.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Për teatrin që e dhatë për bingon dhe falsifikoi sipërfaqen?! Pse? Po të kalonte 500 metra, nuk ishte kompetencë e tij. Pra, aferat e Ramës me teatrin nuk mbarojnë sot, por kanë filluar dhe vazhdojnë.

Albana Vokshi – Zoti Çipi.

(Zoti Fidel Ylli ndërhyrje pa mikrofon.)

Kastriot Çipi – Zoti Ylli, mundem?

Atëherë, e ndoqa me shumë vëmendje fjalën e deputetit Ylli. Ai foli për transparencë, pra na dha të drejtë që ne kërkojmë transparencë, por nuk na tha pse ka munguar transparenca nga ana

e Ministrisë së Kulturës, por edhe e Bashkisë së Tiranës. Për fat të keq, nuk ofroi as vetë transparencë për sa i takon atij si ligjvënës. Tha që ka dosje, por dosjen nuk e paska marrë me vete sot.

(Zoti Fidel Ylli ndërhyrje pa mikrofon.)

Patjetër, unë e kam gjithë ditën... Më dëgjoni, përpara se të merrni dosjen.

Fidel Ylli – A do dosjen?

Kastriot Çipi – Patjetër që e dua dosjen.

(Zoti Fidel Ylli ndërhyrje pa mikrofon.)

Patjetër...

Albana Vokshi – Zoti Çipi, mos bëni replikë, ju lutem! E kam unë dosjen, nuk ka nevojë. Këtu i kam të gjitha.

Kastriot Çipi – Thatë se teatri i ri kushton 20 milionë euro. Ju këtë shifër e keni në ajër. Unë e kam lexuar propozimin që “Fusha sh.p.k” i ka bërë bashkisë dhe nuk ka shifër për teatrin e ri. Mos dezinformoni!

Thatë që ekspertizat e kanë nxjerrë ndërtesën të papërshtatshme dhe të rrezikshme. Ja ku janë ekspertizat. M’i nxirrni ju ku i keni! Ky është raporti i Institutit të Ndërtimit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Vërimi gishtin, ma citoni numrin e faqes dhe numrin e rreshtit! Bëtë pyetjen pse ne nuk kërkuam në vitin 2007 ta shpallte Leskaj monument kulture! Po jua jap unë përgjigjen. Në vitin 2002, ish-ministri i Kulturës, Agron Tato, kishte firmosur petitionin tonë për shpalljen monument kulture dhe bëri deklaratën publike: “Nuk ka nevojë, sepse është i shpallur me VKM-në e vitit 2000”. Nuk mund të kërkonim dublim dokumentesh mbi dokumente, kur e ka firmosur ish-ministri i Kulturës, Agron Tato. Janë 11 deputetë të PS-së që kanë firmosur në vitin 2002. Po na thoni që po e politizojmë ne?! Nuk e kemi ndryshuar ne, por e keni ndryshuar ju. Ju jeni të politizuar si deputetë. Nuk dëgjoni më për kulturën, po nuk morët urdhra nga partia. Sot nuk gjejmë dot një deputet që ta firmosë petitionin, kur teksti është i njëjtit, qëllimi dhe përmbajtja janë njësoj. Çfarë ka ndryshuar?! Teatri është 16 vjet më i vjetër, që do të thotë se janë 16 arsye më shumë për ta ruajtur dhe jo për ta prishur.

Fidel Ylli – Ke qenë sekretar i PD-së... Ne kemi të drejtë të politizohemi, se jemi forcë politike, po ti?! Mbron aktorët sekretari i PD-së!

Kastriot Çipi - Zoti Ylli, meqë jemi në parlament...

(Zoti Fidel Ylli ndërhyt pa mikrofon.)

Zoti Ylli, e di shumë mirë...

Albana Vokshi – Zoti Fidel Ylli, të lutem, po shkatërron mbledhjen.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, nuk e di. Çfarë lidhjeje ka? Po flasim për Teatrin Kombëtar. Hiqeni afilacionin partiak në këtë pjesë! Respektoni pjesën profesionale! Mos ndërhy, të lutem, se po të sqaron për të gjitha!

(Zoti Fidel Ylli ndërhyt pa mikrofon.)

Kastriot Çipi – Zoti Ylli, unë po flas me letra.

(Zoti Fidel Ylli ndërhyt pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Ju lutem, ata kanë ardhur të flasin me ju, se ne ishim të hënë që shkoi...

(Zoti Fidel Ylli ndërhyt pa mikrofon.)

Kanë ardhur të flasin. Kryetari i sindikatës ka kërkuar që të flasë me deputetët e maxhorancës më së shumti, sepse ne ishim në Teatër të hënë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ku e ke debatin politik?! Dëgjojeni, se po ju jep shifra dhe fakte! Ju nuk doni t'i dëgjoni këto, sepse doni që të ndërtoni kullat. Doni të shkatërroni çdo gjë. Doni të shkatërroni kulturën dhe kujtesën për të ngritur kullat tuaja. Dëgjojeni dhe respektojeni!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mos e ndërprisni! Çfarë funksionari? A jeni në terezi? Çfarë po flisni?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Çfarë po bëni kështu? Kjo nuk është normale!

Kastriot Çipi – Meqë është dëgjues me artistët, a mund të flasim ne?!

(Debate pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Zoti Ylli, ke qëllim ta prishësh mbledhjen?! Cili është qëllimi? Dëshiron ta prishësh këtë dëgjese? Respektojini, se është turp!

Kastriot Çipi – A ka mundësi të kthej përgjigje?

(Debate pa mikrofon.)

Albana Vokshi – E ka respektuar në maksimum. Ju nuk po e respektoni.

Kastriot Çipi – Jua them unë, i nderuar, pse po lini nam. Po shpifni, sepse nuk kam qenë asnjë ditë anëtar i asnjë partie.

Fidel Ylli – Sekretar i PD-së...

Kastriot Çipi – Asnjë ditë në jetën time! Nxirri dokumentet! As i Partisë së Punës nuk u bëra, as i PD-së dhe nuk jam i asnjë partie edhe sot.

Albana Vokshi – Fidel, a the që nuk do të ndërhysh?! Pse, more, turp është të jesh sekretar i parties?! Nuk ka qenë, por edhe turp nuk është. Çfarë po thoni? Pse drejtori që është tani, çfarë është?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem!

Kastriot Çipi – Jam absolutisht i depolitizuar

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zoti Ylli, ju thashë, unë nuk kam qenë anëtar as i Partisë së Punës dhe as i Partisë Demokratike. Unë e di që nuk mbani përgjegjësi për deklaratat tuaja, por ju po shpifni.

Albana Vokshi – Vazhdoni me argumentet, zoti Çipi!

Kastriot Çipi – Ju përdorni argumentin, që nuk ka para. Jua them unë ku t’i gjeni paratë. Ju paguani çdo vit për pushimet nga puna në mënyrë të padrejtë 22 milionë euro. 16 milionë euro shpenzuat për një pallat, që u hodh në erë për një sekondë. Ku do t’i gjeni paratë? Jepini kulturës në Shqipëri atë buxhet që jep Maqedonia për kulturën. 65 milionë euro shpenzon Maqedonia për kulturën.

Ju kërkua vjet të na e dyfishonit buxhetin, por refuzuat. Nëse buxheti ngelet po ai, 16 milionë euro, çereku i buxhetit të Maqedonisë, sigurisht që nuk do të këtë para për të rikonstruktuar teatrin!

Së fundi, zoti Ylli, unë ju kam përkrahur dhe falënderuar publikisht për luftën që keni bërë për rikonstruksionin e stadiumit të Shkodrës dhe atij të Elbasanit, por dua t’ju kujtoj që janë bërë që të dy me fonde publike, prandaj edhe Teatri Kombëtar duhet rikonstruktuar me fonde publike. Për këtë kërkoj mbështetjen tuaj dhe të gjithë deputetëve të Partisë Socialiste.

Albana Vokshi – Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ka edhe Taulanda diçka për të thënë.

Taulanta Jupi – Ju keni përballë artistë, ndaj nuk është e lehtë për ne të vijmë në këto pozicione dhe të përfshihemi politikisht.

E kam thënë në takimet e vazhdueshme, madje edhe në takimin e ditës së hënë, që jemi përpjekur maksimalisht ta mbanim jashtë vëmendjes politike këtë lëvizje, por, siç e shikoni, është

e pamundur. Ju lutem, në respekt të artistëve që ne përfaqësojmë, mos e politizoni këtë çështje. Diskutoni me argumente dhe ju lutem, mos sulmoni pa ditur faktet reale se përse ne kemi ardhur këtu dhe si kemi ardhur këtu. Më lejoni të shtoj edhe një fjali. Do të jemi i vetmi vend në Europë që nuk kemi mundësi të ndërtojmë teatër kombëtar me fonde publike.

Albana Vokshi – Faleminderit!

Po, Luan.

Luan Baçi – Unë mendoj të mos bëjmë teatër duke folur për teatrin. Në fakt, ne, të dyja palët, duke përfituar edhe nga mediat, filluam të bëjmë teatër duke u përplasur.

Përfaqësuesit e artistëve kanë ardhur për një problem të caktuar. Nga diskutimet që janë bërë gjatë 3 muajve, por edhe nga diskutimet që kolegët e maxhorancës bënë, duke përfshirë edhe zotin Ylli, ishte rënë dakord parimisht që teatri duhet të ndërtohej aty ku është pa u prishur, por justifikimi ka të bëjë gjithmonë me paratë. “Nuk kemi para që t’ia ofrojmë një firme private për ta ndërtuar”.

Derisa edhe ju e keni këtë mendim, unë mendoj se ekziston mundësia që shteti, qeveria, me forma nga më të ndryshmet, të qëndrojnë te kjo kërkesë e artistëve dhe jo te kërkesa e deputetëve të opozitës. Përderisa Kryeministri ka thënë me një ton urdhërues që teatri do të shembet, ju e keni të pamundur të bini dakord e të thoni mendime të ndryshme. Këtë gjë e mirëkuptoj.

Teatri është pronë publike, nuk është e artistëve, e deputetëve, e opozitës apo e maxhorancës, prandaj mendoj që diskutimi duhet të jetë me serioz dhe jo politik.

Ashtu siç e thanë edhe zotërinjtë përfaqësues të artistëve, ata nuk kanë ardhur këtu të bëhen palë as me opozitën dhe as me maxhorancën, por të bëhen palë me pronën publike, kulturën dhe historinë e teatrit. Mendoj që takimi i sotëm me artistët duhet të kishte marrë rrjedhë tjetër, sepse ne e kemi arenën tonë të teatrit politik në parlament.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Jo, nuk e dëgjuat me vëmendje. Kjo është për të ardhur keq.

Po, Kejdi.

Kejdi Mehmetaj – Faleminderit!

Argumentet që u dhanë nga sindikata e artistëve ishin shteruese, kështu që unë nuk do të zgjatem shumë, por do të ndalem në disa pika.

Së pari, ne nuk po arrijmë dot të kuptojmë njëri-tjetrin. Deputetët e maxhorancës thonë që ende nuk ka një vendim nëse teatri do të shembet. Ndërkohë, 4 apo 5 ditë më parë, unë e gjeta

postimin, Kryeministri ka postuar në faqen e tij zyrtare lajmin se teatri do të shëmbet. “Për këdo që bën bla-bla-bla, ta dijë përfundimisht që teatri do të shëmbet”. Jua lexoj postimin e plotë nëse doni, por besoj se ju e keni lexuar më mirë sesa unë. Nuk e kuptoj qëndrimin tuaj për këtë çështje. Është ai që thotë Kryeministri, ai që na tha ministrja, ai që thoni ju apo ka diçka tjetër që ne ende nuk e dimë?

Mendoj se diskutimi për këtë çështje fillon pikërisht tek transparenca, që edhe kolegu Ylli kërkoi. Kjo është transparenca. Pesë zëra të ndryshëm, ku secili thotë atë që mendon, por akoma nuk e dimë ekzaktësisht se çfarë mendohet të ndodhë. Qeveria duhet t’ia shpjegojë qëndrimin e saj deputetëve, aktorëve, që janë grupi i interesit, por në radhë të parë qytetarëve.

Nga ana tjetër, unë nuk e kuptoj shprehjen tuaj: “Kjo nuk duhet të bëhet politike”.

Për aq kohë sa ne jemi të zgjedhur të qytetarëve, një pjesë jona janë deputetë të Tiranës, pa diskutim që kjo është politike, sepse ne flasim në emër të atyre njerëzve që na kanë zgjedhur. Unë e kuptoj që është frikë e madhe të thuhet fjala “politike” dhe është fjala më e padëshiruar nga qytetarët, por është bërë pikërisht nga kjo që ne bëjmë këtu sot.

Politike do të thotë që ne të interesohemi, në funksionet që kemi, për një çështje që prek qytetarët që ne përfaqësojmë. Në qoftë se flasim për interesa, atëherë është frikë që të bëhet politike. Unë jam shumë e bindur që kolegët e maxhorancës, të paktën ata që janë në këtë sallë, nuk kanë ndonjë interes të caktuar as atje, as me ndërtuesin dhe as me biznesmenët, përkundrazi, besoj se po aq sa ne, këtu kemi kolegë që në vitet e mëparshme edhe mund të kenë qenë iniciatorë të mbrojtjes së Teatrit Kombëtar, duam që ajo godinë të jetë në shërbim të qytetarëve tanë.

Nga ana tjetër, kur u drejtohem qytetarëve dhe e dimë që po flasim nëpërmjet mediave me ta, dokumentet që vijnë, t’i lexojmë me më shumë kujdes. Në asnjë prej raporteve që kanë ardhur, edhe ato që ka sjellë vetë ministria, nuk thuhet që teatri duhet shembur. Në qoftë se teatri duhej shembur, ai do të ishte shembur vetë dhe aty sot nuk do të mund të rrinte një roje e jo të zhvilloheshin çdo ditë shfaqje.

Padyshim që ka nevojë për ndërhyrje, këtë nuk po e themi sot, por mund të jetë thënë para 23 vjetëve, sepse kushtet janë shumë larg për të qenë të përshtatshme, por besoj se në këtë sallë ka kolegë që e dinë se ai teatër mund të bëhet edhe nga e para dhe të duket po njësoj si sot, modern, me të gjitha kushtet brenda, madje me më shumë hapësira dhe për qytetarët të ruajë imazhin e Teatrit Kombëtar, që ne kemi.

Nga ana tjetër, ka edhe zgjidhje të tjera. Teatrin ekzistues mund ta rikonstruktojmë dhe kështu ngelet pjesë e memories së qyteti me shfaqje të herëpashershme, por ndërkohë, në partneritet me privatin, e gjen qeveria zgjidhjen, në zona të tjera të Tiranës të ndërtojmë një apo dy teatro të tjerë.

Tirana sot ka një milion banorë, kështu që, edhe nëse do ta ndërtojmë tre herë më ta madh nga ky që është, në po të njëjtin vend, nuk besoj se ezaurohen kërkesat e qytetarëve. Atje ka vend edhe për dy të tjerë. Sa më shumë teatro të rikonstruktohen dhe sa më shumë të rinj të ndërtohen, absolutisht që është gjë e mirë, por jo në atë që është elementi i identitetit tonë kombëtar.

Teatri ynë Kombëtar është i vetmi institucion që ne kemi, i cili në memorien tonë, përveç atyre të antikitetit, lë gjurmë të kulturës së skenës. Për këtë gjë, besoj se secili prej nesh duhet të tregojë pak më shumë përgjegjshmëri kombëtare në sensin e detyrës që ne mbajmë.

Meqenëse jemi komision përgjegjës për këtë çështje dhe e ndjekim kulturën dhe artin më afër se komisionet e tjera, le të jemi edhe ne gjysmë iniciatorë për të kërkuar më shumë transparencë dhe për të dhënë edhe disa zgjidhje.

Të mos vëmë me shpatulla pas murit artistët, të cilët po bëjnë më shumë nga sa u takon. Në fund të ditës ata janë pjesë e skenës, por përfituesit e vërtetë të atij teatri janë qytetarët që ne përfaqësojmë.

Faleminderit.

Alert Çeloaliaj – Meqenëse u rikthyem te diskutimi i politizimit, jam i detyruar të them këtu, meqenëse ne nuk lexojmë vetëm një krah të politikës, por të gjithë krahët e politikës të interesuar për problemin emergjent të Teatrit Kombëtar dhe atij Eksperimental, se ekziston edhe një mendim tjetër. Jemi akuzuar nga kolegët tanë, por edhe nga njerëz që na njohin vetëm publikisht, se jemi të manipuluar nga Partia Demokratike, ndërkohë, në blogje të caktuara në internet, ekziston mendimi që ne jemi këlyshë të Edi Ramës, të cilët bëjnë zhurmë për të larguar vëmendjen e opinionit publik nga problemet që Kryeministri ka sot në politikë.

Dua t'ju them edhe një herë që e vërteta qëndron gjithmonë në mes. Ne kemi ardhur këtu për teatrin monument kulture, duke e ruajtur teatrin. Nuk kemi asgjë kundër biznesit apo iniciativave private. Kërkesa jonë është shumë e qartë dhe shumë e prerë: të shpallet monument kulture, të ruhet dhe të rikonstruktohet. Përsëritim qeverinë, e cila do të ndërtojë teatro të tjerë, sepse sa më shumë të ndërtojë, aq më mirë do të jetë. Arsyeja pse nuk kemi folur, kur u tentua që

të bëhej Piramida teatër, as kur u ndërtua “Turbina”, është se ne kërkojmë të ngrihen sa më shumë teatro që të jetë e mundur pa prishur Teatrin Kombëtar.

Unë, për sa i përket politizimit, e përsëris edhe një herë, do të bashkohem me këdo shok dhe kolegun tim, me çfarëdolloj bindje politike apo besimi fetar, për mbrojtjen e Teatrit Kombëtar.

Për sa i përket çështjes së sigurisë, që u përmend këtu, është kriminale që ministria e linjës lejon dikasterin e saj të vërë në rrezik jetët e mbi 600 fëmijëve fundjavave, në qoftë se ka dokumente që vërtetojnë se godina është e rrezikshme për jetën.

Për sa i përket pyetjes së zotit Boçi për fondacionin, ajo është një ide mjaft e vjetër, ka filluar në vitin '98, dhe ne, prej themelimit të sindikatës në janar të vitit 2018, kemi filluar punën dhe jemi në process, pa marrë sugjerime nga deputetët e opozitës. Të mos kujtojë kush që ky sugjerim vjen nga Partia Demokratike. Është një përpjekje 20-vjeçare, të cilën ne po përpiqemi ta ringjallim.

Gjithsesi, për ne do të ishte jashtëzakonisht shumë interesante që dikush të provonte që ne e kemi gabim me argumentet që sjellim. Për mua, meqenëse munguan në mbledhjen e para një jave në Teatrin Kombëtar, do të ishte e rëndësishme t'i dëgjoja këto argumente nga deputetët e maxhorancës.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Faleminderit!

Personalisht ju përgëzoj për qëndresën tuaj prej më shumë se 9 javësh. Të paktën ne deputetët e opozitës, të Partisë Demokratike dhe të LSI-së, kemi shprehur mbështetjen ndaj jush dhe ndaj të gjithë atyre që prej më shumë se 9 javësh po rezistojnë.

Jam e sigurt që kemi edhe miratimin e deputetëve të maxhorancës, sepse është e qartë, ata nuk kanë çfarë të mbrojnë, por janë të detyruar të mbrojnë diçka që nuk është e mbrojtshme.

Ne do të vazhdojmë të kryejmë rolin tonë si deputetë të këtij komisioni, do të vazhdojmë të kërkojmë transparencë, e cila juve nuk ju është bërë asnjëherë, edhe ndaj nesh nuk është bërë asnjëherë, në kundërshtim me ligjin dhe me Kushtetutën, si dhe për çdo kërkesë tjetër për mbështetje. Mbase do të keni edhe kërkesa të tjera ndaj nesh dhe ne, si komision apo edhe si deputetë, nëse nuk bëhemi dot si komision, mund t'ju mbështesim për të mbrojtur sadopak atë pjesë të monumenteve të kulturës, që nuk është rrënuar ende.

Urdhëroni, Milva!

Milva Ekonomi – Faleminderit shumë që keni ardhur!

Sa për t'ju vënë në dijeni, kërkesa për takimin e sotëm erdhi vërtet nga pala opozitare, por ne qëmë të gatshëm të dëgjonim çdo kërkesë tuajën. Për këtë arsye jemi këtu. Ne ramë dakord që edhe pa qenë në rendin e ditës, ju të ishit pjesë e mbledhjes sonë të sotme. Kjo ishte edhe arsyeja pse u larguat për pak kohë nga komisioni dhe ne morëm vendimin që ju të ishit këtu.

Dua t'ju vë në dijeni se në harkun kohor të 8 javëve ne kemi kërkuar takime me ministren e Kulturës dhe në fakt, Ministria e Kulturës ka sjellë këtu një dosje me firmën e ministres me shumë informacione, në lidhje me situatën e Teatrit. Ajo që tha zoti Ylli këtu, është pikërisht ajo që ne e dimë, që ky është një projekt që s'ka marrë akoma formë të prerë dhe është në një fazë diskutimi. Prandaj, për këtë arsye transparenca është shumë e nevojshme nga ky çast e tutje, sepse për ju kjo po bëhet një çështje e rëndësishme.

Vlen të theksoj edhe një moment tjetër. Ju erdhët këtu si përfaqësues të sindikatave. Në qoftë se do të shikojmë detyrën kryesore të sindikatës, ajo është të mbrojë punonjësit e saj për mënyrën se si punojnë, paguhen apo i kanë të jetueshme kushtet e punës.

Në fakt nuk dëgjuam nga ju asnjë kërkesë në lidhje me kushtet e punës së artistëve, nëse ka nevojë që këto kushte të përmirësohen apo jo.

Për rrezikshmërinë që ka Tetari, ne kemi dëgjuar në harkun kohor të 9 javëve që pranë Teatrit Kombëtar janë bërë disa rikonstruktime në pjesën lindore dhe atë jugore, aty ku dukej sikur do të binin disa shtylla, për të lehtësuar vazhdimësinë e jetës teatrore në Tiranë.

Nga shkresat që ne kemi, Teatri Kombëtar dhe Teatri Eksperimental janë dy struktura ndërtimore të ndryshme nga njëra-tjetra dhe vështirësia e mbijetesës arkitektonike të tyre nuk paraqitet njësoj. Ne e kemi marrë edhe këtë informacion.

E dyta që dua t'ju them, për arsye se mendohet nga ministria dhe në përgjithësi që jeta kulturore në Tiranë duhet të aktivizohet më gjerësisht, sikurse e thanë edhe kolegët e mi të opozitës, që ka nevojë për teatro të tjera, kjo është një nga arsyet pse teatri "Turbina", teatri "Tulla" është një sipërmarrje private, është një investim i ri, i cili po i vjen në ndihmë komunitetit të artistëve për t'i zhvilluar shfaqjet atje. Teatri "Turbina" është në përfundim dhe dalëngadalë një pjesë e kalendarit teatror do të kalojë atje. Ky është informacioni që ne kemi marrë.

Gjithashtu, kemi marrë informacionin që TOB-i është një strukturë, e cila po rinovohet plotësisht, duke bërë që teatri ta ketë më të mirë akustikën dhe kushtet e jetës për spektatorët në kohën e shfaqjeve, si në verë, si në dimër. Ne kemi ndjekur edhe programin që ka ndërmarrë qeveria në projektin e rehabilitimit të TOB-it. Kështu, unë besoj që nevoja për të qenë afër jush

për të dëgjuar çdo problem që keni, nuk vjen vetëm nga opozita, por edhe pozita e ka këtë shqetësim. Situata e Teatrit Kombëtar është një situatë, e cila kërkon vazhdimisht informacion për të kuptuar se si do të jetë projekti, çfarë po ndodh, cili do të jetë territori, cili territor cenohet dhe cili territor nuk cenohet.

Nga ana tjetër, ne kërkojmë, gjithashtu, që komunikimi me komunitetin e artistëve të jetë një komunikim i vazhdueshëm. Asnjëherë ne nuk e ndërpresim këtë komunikim.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ky është një fakt që po ndodh. Ne do të vazhdojmë të mbajmë këtë qëndrim.

Albana Vokshi – Faleminderit!

Ne i dëgjuam të gjitha qëndrimet.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Tani më duhet ta mbyll.

Kastriot Çipi – Shumë shkurt.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Faleminderit zonja Ekonomi për tonin dhe për marrëdhënien që vendosët në këtë sallë!

Ne na u tha që sot do të vendoset për çështjen e ndërtesës së Teatrit Kombëtar dhe kërkesës sonë për ta shpallur monument kulture. Kur të dëshironi të na thërrisni për çështjen e të drejtave të artistëve, të drejtave ekonomike të tyre, jemi shumë të interesuar. Mund të themi që Ministria e Kulturës e refuzon dialogun prej 3 muajsh. Ajo duhej të firmoste me ne një kontratë kolektive, e cila duhej të ishte e detyrueshme për zbatim për të gjithë punëdhënësit e tjerë.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Faleminderit!

Atëherë, ju falënderoj që erdhët dhe që shprehët shqetësimet tuaja!

Ne të gjithë, në fakt, pranuam t'ju dëgjonim, pavarësisht se sot ka edhe një lajm tjetër, i cili është bërë publik vetëm para pak minutash nga selia e PD-së, ku ministri i Brendshëm aktual dhe vëllai i tij janë koka të krimit të organizuar, ndaj, unë mendoj që ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

... ku e keni çuar shtetin dhe prandaj nuk merreni me teatrin dhe nuk e keni problem për ta shkatërruar atë, sepse droga...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

... sepse droga e ish-ministrit të Brendshëm dhe droga e vëllait të ministrit të Brendshëm aktual duhet të pastrohet pikërisht te ndërtimi i teatrit. Ky është lajmi i sotëm dhe për këtë ju duhet të jeni të shqetësuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Sot ju jeni të shqetësuar.

Shihni se çfarë po bëhet në qeverinë tuaj!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Adelina Rista – Të lutem, mikrofonin nuk është i Selisë së Partisë Demokratike, por i komisionit. Mos e përdorni për deklaratat politike. Ato bëjnë te Selija e PD dhe në sallën e parlamentit, jo në komision. Në komision jemi për Teatrin. Mos bëni teatër! Ju po bëni *shou* mediatic.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Unë do të doja ta mbyllnim me premtimin nga ana juaj që do të rishikoni buxhetet për artin dhe për kulturën.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Adelina Rista – Zonjë e nderuar, po shkelni të gjitha procedurat. Kjo që thoni ju, nuk ka lidhje fare me Komisionin e Edukimit dhe Medias.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Aspak!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Axhenda e ditës së sotme të komisionit ka dy çështje.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë kam punuar deri në orën 16:00 në ditët e tjera me komisionet.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në rendin e ditës kemi dy çështje: dëgjuesën dhe vijimin e shqyrtimit të projektligjit.

Rrini edhe ju! Uluni!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kastriot Çipi – A mund t’ju sjellim propozimin për shpalljen e Teatrit Kombëtar “monument kulture”, që ta firmosni edhe ju? Deri tani kanë arritur 780 firma.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ne jemi pa shtëpi.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Flasim edhe për buxhetin.

I nderuar, unë mund t'ju jap tani përgjigje edhe për të drejtat e punonjësve.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ne jemi gati të diskutojmë edhe për këtë, kur të doni: edhe sot, edhe ndonjë ditë tjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ne e shpjeguam shumë qartë dhe do t'jua lëmë edhe dokumentet. Ne jemi për rikonstrukcionin e Teatrit dhe për ndërtimin e një teatri të ri.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

(Largohen deputetët përfaqësues të opozitës në Komision)

Milva Ekonomi – Faleminderit!

Axhenda e ditës së sotme kishte dy çështje.

Çështja e dytë ka të bëjë me diskutimin nën për nën të projektligjit “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”. Janë ftuar të marrin pjesë në mbledhje përfaqësues nga Ministria e Kulturës dhe nga Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim, të cilët janë duke ardhur.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Para se të vijmë të ftuarit, me të cilët do të diskutojmë projektligjin, dua t'ju them se në komision janë depozituar edhe disa shkresa të tjera.

E para ka të bëjë me propozimin e AMA-s për një ndryshim në strukturën dhe organikën e AMA-s, meqenëse AMA është një institucion që varet nga komisionet parlamentare, pra nga Kuvendi. Ndryshimi i strukturës ka të bëjë me një funksionim më të mirë të AMA-s. Për këtë arsye unë do të thosha që ta marrim në shqyrtim këtë kërkesë.

Gjithashtu, ata kanë bërë edhe një kërkesë për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9584, datë 17.07.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, që lidhet me të ardhurat që ata gjenerojnë dhe me mundësinë për të pasur detyra funksionale më të drejta në raport me pagesën për punë. Të dyja këto shkresa, para se t'i shqyrtojmë, unë i kam dërguar te Shërbimi i Monitorimit i Kuvendit.

Zonja Sonila Kadare, si përherë, i ka shqyrtuar dhe ne kemi rënë dakord që pjesa e strukturës është vendim që na takon neve, ndërsa për pjesën e pagesës, nuk mund të merret një vendim, nëse nuk ka më parë një këshillim nga Ministria e Financave. Prandaj sot, meqenëse e

plotësojmë kuorumin, është shumë e rëndësishme që të biem dakord që këto dy shkresa t'i dërgojmë në drejtimin e duhur për të filluar procedurën. Pra, për ndryshimin e strukturës dhe për kërkesën për dhënie mendimi të Ministria e Financave.

Jeni dakord të veprojmë kështu për këto dy shkresa?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Çështja tjetër, është plotësimi i 3 vendeve vakante në KD të RTSH-së. Mbasi komunikova me kryetaren, dakordësuam që ne ta hapim dëgjuesën për këto 3 kandidatura. Kështu, duhet të bëhemi gati që në kalendarin e veprimtarisë së komisionit, të parashikojmë seancat dëgjimore me kandidaturat përkatëse.

Kemi edhe një kërkesë për shqyrtimin e projektligjit “Për një ndryshim në ligjin nr. 34/2017, “Për lirin e frekuencave të dixhital-dividentit””.

Do t'ju lutesha shumë ta lexoni këtë projektligj për ta pasur në konsideratë se si do të veprojmë në ditët në vazhdim.

Mbyllet pika e parë e rendit të ditës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 14.05.2018, ora 12:30

Drejton mbledhjen:

Milva Ekonomi – nënkryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Fillimi i diskutimit nen për nen i projektligjit “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”(komision përgjegjës).

Marrin pjesë:

Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Fatmir Velaj, Adelina Rista, Fadil Nasufi, Ismet Beqiraj, Bujar Çela, Almira Xhembulla, Anduel Xhindi (*deputet zëvendësues*).

Mungojnë:

Albana Vokshi, Romeo Gurakuqi, Valentina Duka, Luçiano Boçi, Luan Baçi, Kejdi Mehmetaj, Shezai Rrokaj dhe Nora Malaj.

Të ftuar:

- Sofjan Jaupaj – këshilltar i Ministres,
- Ekflodia Leskaj – këshillues ligjor AADF,
- Eris Hysi - avokate mbështetëse.

Vijon pika e dytë e rendit të ditës

Milva Ekonomi – Viojmë tani me projektligjin “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”. Këtu kemi dy përfaqësues, të cilët vijnë nga Ministria e Kulturës dhe nga Fondacioni Amerikano-Shqiptar për Zhvillim.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Siç ju vura në dijeni, për këtë projektligj është punuar me një kuorum, i cili pa gjysmën e vëzhgimeve që kishin ardhur nga Komisioni i Ligjeve dhe të të gjitha grupeve të interesit që kishim dëgjuar këtu. Gjej rastin të falënderoj zotin Muhamet Bela, për këshillimin e bërë dhe punën e jashtëzakonshme për grumbullimin dhe hulumtimin e çështjeve, si dhe për të gjitha materialet shkencore!

Pra, projektligji që kemi sot është parë edhe një herë dhe është riformuluar. Ndryshimet kanë ndodhur që në nenin e parë, ku është bashkuar qëllimi i projektligjit “Për trashëgiminë kulturore” dhe atij “Për muzetë” në një nen me një pikë, jo një nen me dy pika. Po kështu ka ndodhur edhe tek objekti, ndërsa punën më të madhe në fazën e parë e ka marrë pjesa e projektligjit, që lidhej me përkufizimet, të cilat janë hulumtuar të gjitha një nga një, janë parë të gjitha burimet shkencore dhe juridike për këtë gjë, për të arritur te ky variant përfundimtar që ne kemi sot.

Ju bëj thirrje që të kalojmë në diskutimin nen për nen, deri te pjesa e parë e projektligjit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Le të fillojmë tani me pjesën e parë “Dispozitat e përgjithshme”.

Titulli i parë “Qëllimi dhe parimet e përgjithshme”.

Neni 1. Biem dakord?

(Të pranishmit shprehen dakord.)

Neni 2 “Objekti”. Biem dakord?

(Të pranishmit shprehen dakord.)

Neni 3 “Parimet e trashëgimisë”...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Sipas këshillës që po më jep këshilltari ynë juridik, duhet të lexoj ndryshimet që janë bërë te çdo nen.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, vetëm ndryshimet.

Atëherë, neni 1 ndryshon kështu: “Qëllimi i këtij ligji është ruajtja, mbrojtja, vlerësimi dhe administrimi i trashëgimisë kulturore kombëtare, trashëgimisë kulturore muzeore, peizazhit, si kontribues i ruajtjes së kujtesës kombëtare, përfaqësimit material dhe të dukshëm të identitetit kombëtar, si shprehje e vlerave kulturore, si nxitje e zhvillimit kulturor në vend, duke siguruar edhe parandalimin e trajtimit të paligjshëm të objekteve kulturore”.

Biem dakord?

(Të pranishmit shprehen dakord.)

Neni 2 “Objekti” ndryshohet si vijon: “Objekti i këtij ligji është përcaktimi i rregullave, procedurave dhe autoriteteve shtetërore përgjegjëse për ruajtjen, mbrojtjen, vlerësimin, administrimin e pasurive të vlerave të trashëgimisë kulturore, të trashëgimisë kulturore muzeore, si dhe vlerave kombëtare të peizazhit, pavarësisht vendndodhjes së tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë”.

Biem dakord?

(Të pranishmit shprehen dakord.)

Neni 3 ka disa ndryshime shumë të lehta për sa i takon procedurës legjislative. Në nenin 3 të vjetër...

Bujar Çela – Për procedurë.

Listëprezenca e dytë do të vijë?

Milva Ekonomi – Po, ja do t’i themi Arianës.

Në nenin 3, në hyrje të pikës 1, thuhet: “Ky ligj zbatohet duke u bazuar në krijimin e kushteve”. Në përgjithësi, në vend të fjalëve informuese, do të përdoren fjalë detyruese dhe do të themi: “Zbatimi i këtij ligji bazohet...”.

Ndryshimet janë të rekomanduara nga Komisioni i Ligjeve.

Biem dakord?

(Të pranishmit shprehen dakord.)

Neni 4 ndryshon si më poshtë: “Titulli i nenit “Vlera kulturore” merr emrin “Pasuritë kulturore”, si dhe në pikën 1 të këtij neni, ku thuhet: “Trashëgimia kulturore përfshin pasuritë

kulturore, materiale dhe jomateriale, si dhe një tërësi vlerash kulturore në bazë të kujtesës historike të identitetit kombëtar, që kanë rëndësi shkencore ose kulturore” janë hequr fjalët “të luajtshme dhe të paluajtshme”.

Biem dakord me këtë riformulim?

(Të pranishmit shprehen dakord.)

Në nenin 5 ndodhin këto ndryshime.

Unë do t’jua lexoj nenin 5 me ndryshimet, sepse është ribërë i tëri.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ka shpjegim termash, po.

Edhe një herë, biem dakord me nenin 4?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Miratohet.

Kalojmë te neni 5, ku do të bëj leximin pikë për pikë të tij, sepse ndryshimet janë të konsiderueshme. Atëherë, titulli i këtij neni është “Përkufizimet” dhe ka këtë përmbajtje: “Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime: “Akreditim i muzeve” është procesi i pavarur për vlerësimin e kritereve, i cili përcakton nëse muzeu dhe/ose aktiviteti muzeor i tij përmbush standardet e caktuara të cilësisë, edukimit, sigurisë, ruajtjes dhe mbrojtjes së vlerave kulturore në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

2. “Ansambël historik urban” është struktura e dallueshme urbanistike-arkitekturore, pjesë e trashëgimisë kulturore të paluajtshme, elementet e së cilës janë në ndërlidhje të caktuara, të rëndësishme, hapësinore dhe estetike ndërmjet tyre dhe me mjedisin përreth.

3. “Arkiv” është përcaktimi sipas ligjit “Për arkivat në Republikën e Shqipërisë”.

4. “Artizanat” është puna, nëpërmjet së cilës objektet e nevojshme dhe dekorative janë të punuara tërësisht me dorë dhe mjete të thjeshta. Veprimtaria e artizanëve rregullohet me ligj të veçantë.

5. “Bazë të dhënash shtetërore e pasurive kulturore” është grumbullimi i organizuar i informacionit për të gjitha pasuritë kulturore kombëtare, në pronësi publike e private, i ruajtur në formë elektronike, ku përpunimi dhe përditësimi i tij kryhet nëpërmjet një sistemi kompjuterik, si pjesë e plotësimit të detyrimeve ligjore të institucionit administrues.

6. “Bibliotekë” është përcaktimi sipas ligjit “Për bibliotekat në Republikën e Shqipërisë”.

7. “Certifikatë e pasurive kulturore” është dokumenti zyrtar, i lëshuar nga autoriteti kompetent shtetëror, që përcakton statusin juridik të pasurive kulturore, në pronësi publike dhe private, sipas dispozitave të këtij ligji. Ajo përmban tërësinë e të dhënave identifikuese të pasurive kulturore në Republikën e Shqipërisë, referuar kritereve dhe standardeve ndërkombëtare, të cilat regjistrohen dhe mbahen në Regjistrin Kombëtar të Pasurive.

8. “Dëmtimi” është tërësia e veprimeve, të qëllimta ose jo, në pasuritë kulturore, që cenojnë tërësinë ose elemente të veçanta të këtyre pasurive.

9. “Dokument regjistrimi” është çdo akt publik, vendim gjykate apo i një organi tjetër shtetëror kompetent, i lëshuar në rastet e parashikuara nga ky ligj dhe që është i detyrueshëm për regjistrimin e pasurive kulturore, sipas dispozitave të këtij ligji.

10. “Folklor gojor” është teksti i krijuar nga populli, i pashoqëruar me muzikë, i cili përcillet gojarisht ose lexohet.

11. “Folklor instrumental” është një krijim muzikor popullor i interpretuar me vegla muzikore popullore.

12. “Folklor koreografik” janë valle dhe krijime të tjera që kërcëhen, me ose pa shoqërim muzikor.

13. “Folklor vokal” është krijimi muzikor i kënduar apo interpretuar me tekst dhe muzikë.

14. “Fond muzeor kombëtar” është e gjithë pasuria, publike dhe private, me vlera muzeore në administrim të muzeve publikë ose privatë të akredituar, që e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Republikën e Shqipërisë.

15. “Gërmim-shpëtimi” është misioni i shërbimit publik, pjesë përbërëse e arkeologjisë. Ai drejtohet nga parime të zbatueshme, si në çdo gërmim shkencor, dhe ka si objekt të sigurojë nëntokë, mbitokë dhe nënujë, në afatet e duhura, zbulimin, konservimin ose ruajtjen, me anën e studimit shkencor të elementeve të trashëgimisë arkeologjike, të prekur apo që mund të preken nga punimet ndërtuese të çdo natyre apo nga planet për zhvillimin e territorit. Gërmim-shpëtimi ka, gjithashtu, si objekt, interpretimin dhe shpërndarjen e rezultateve të arritura.

16. “Gërmim arkeologjik” është ndërhyrja e plotë në nëntokën arkeologjike. Ai kryhet sipas mënyrës frontale të avancimit, zgjerimit të sipërfaqes së gërmimit të mëparshëm ose nëpërmjet parcelimit (copëzimit) të sipërfaqes arkeologjike, të diktuar prej hapave paralelë të ndërtimit. Për të gjitha këto raste, secilës njësi arkeologjike që zbulohet do t’i bëhet prerja,

hulumtimi dhe dokumentimi. Ajo do të kryhet nga arkeologu (drejtuesi i gërmimit), tekniku i gërmimit, konservuesi i mjediseve arkeologjike, personeli plotësues teknik (skicograf, fotograf).

17. “Hulumtim arkeologjik” është vlerësimi i potencialit arkeologjik, vëzhgimi sipërfaqësor (sipas nocionit klasik, si dhe metodave të reja për vëzhgimin arkeologjik, si, për shembull, studimet, gërmimet arkeologjike dhe me gjeoradar e të tjerë), sondazhet arkeologjike, gërmimi arkeologjik, monitorimi, konservimi, administrimi arkeologjik, si dhe përpilimi i dokumentacionit të nxjerrë prej kësaj veprimtarie, raporteve paraprake dhe përfundimtare deri në botimin e rezultateve.

18. “Inventarizim” është regjistrimi dhe identifikimi i objekteve të pasurive kulturore.

19. “Katalogim” është regjistrimi i të dhënave, sipas kritereve të caktuara shkencore për identifikimin dhe administrimin e pasurive kulturore.

20. “Katalogu Kombëtar i Pasurive Kulturore” është baza e të dhënave shtetërore, që mbledh dhe administron, në nivel qendror, të dhënat mbi pasuritë kulturore kombëtare nëpërmjet Sistemit Informatik Kombëtar të Administrimit të Pasurive Kulturore.

21. “Kryevlerë e trashëgimisë jomateriale” (ku fjala më parë ka qenë “kryevepër”, ndërkohë tani është bërë “kryevlerë”) është krijimi, praktika ose dukuria e trashëgimisë jomateriale, e cila, për karakteristikat e saj të veçanta kombëtare dhe më gjerë, gëzon statusin e mbrojtjes ligjore nga ana e shtetit.

22. “Koleksion” është një bashkësi objektesh muzeore me karakteristika të përbashkëta në vlera historike dhe kulturore.

23. “Koleksione publike” janë ato koleksione që janë të aksesueshme, pavarësisht të drejtave të pronësisë së mbajtësit, ku përfshihen objekte me interes artistik, dokumentar, historik dhe shkencor.

24. “Koleksion muzeor” është tërësia e objekteve muzeore të pandashme, të cilat janë të lidhura një nga një ose në disa karakteristika dhe nga vlerat e tyre historike, edukative dhe artistike.

25. “Kompleks historik arkitektonik” është një tërësi ndërtimesh të periudhave të njëjta, por edhe të ndryshme historike, pjesë të trashëgimisë kulturore të paluajtshme, të cilat kanë një lidhje të ngushtë funksionale dhe kulturore ndërmjet tyre.

26. “Konservimi paraprak” përfshin të gjitha masat e ndërmarra, që nuk kërkojnë ndërhyrje direkt në pasuritë kulturore materiale, siç janë krijimi i kushteve të përshtatshme (lagështi relative,

temperaturë, pastërti nga ndotja atmosferike, dëmtimi biologjik dhe fizik në fonde, ekspozimi dhe transporti), me qëllim parandalimin e çdo lloj dëmtimi.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E morëm përsipër, ndaj ta çojmë deri në fund.

Vazhdojmë me pikën 27 “Konservim i integruar” është metodologjia, që nënkupton pajtimin e kërkesave të konservimit me objektivat e planifikimit dhe menaxhimit urban, të cilat duhet të kenë për qëllim krijimin e harmonisë, shmangien e funksioneve të padëshiruara dhe mirëmbajtjen e nivelit ekzistues të vlerave funksionale dhe kulturore.

28. “Kthim” është kthimi fizik i pasurive kulturore në territorin e Republikës së Shqipërisë.

29. “Listë kombëtare e kryevlerave të trashëgimisë kulturore jomateriale” është lista e veprave të trashëgimisë kulturore jomateriale, që kanë status ruajtjeje të shpallur zyrtarisht nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore jomateriale, e cila krijohet, mbahet dhe përditësohet pranë Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore.

30. “Listë e kryevlerave të trashëgimisë jomateriale në rrezik” është lista e veprave të trashëgimisë kulturore jomateriale që kanë nevojë urgjente për ruajtjen dhe transmetimin e tyre.

31. “Mbrotjtja” është ndërmarrja e një sistemi masash me natyrë administrative, juridike, financiare dhe fizike, me qëllim ruajtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore, në interesin më të mirë të komunitetit.

32. “Ministria” është ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.

33. “Mirëmbajtja” përfshin të gjitha masat praktike dhe teknike që duhen ndërmarrë, në mënyrë që pasuria kulturore të mbahet në ato lloj kushtesh e standardesh që japin kënaqësi maksimale, pa dëmtuar vlerat kulturore. Ky është një proces i vazhdueshëm, programi i të cilit monitorohet.

34. “Monitorimi arkeologjik” është një program vëzhgimi dhe hetimi i kryer gjatë zbatimit të një projekti zhvillimor, brenda një zone të caktuar apo siti, në tokë ose nën ujë, ku ekziston mundësia që depozitimet arkeologjike mund të prishen ose të shkatërrohen. Ky proces nënkupton praninë e specialistëve arkeologë gjatë zhvillimit të punimeve të projektit deri në përfundim të gërmimeve dhe rezulton me përgatitjen e një raporti dhe arkivimin e të dhënave.

35. “Mbikëqyrje arkeologjike” është procesi i këqyrjes në terren, nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore dhe subjektet e licencuara i proceseve arkeologjike dhe ecurisë së punimeve të gërmimit gjatë zbatimit të projekteve zhvillimore, të miratuara nga organi

vendimmarrës, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

36. “Monument kulture” është objekti ose ndërtimi me vlera historike kombëtare që mbrohet nga shteti. Në kuptim të këtij ligji, në bazë të intensitetit të ndërhyrjes në pasuritë kulturore, këto të fundit kategorizohen në:

a) “Monument kulture i kategorisë I” është ndërtimi me vlera të spikatura dhe me rëndësi të veçantë për trashëgiminë kulturore, i cili ruhet në tërësinë e përbërësve të tij arkitektonikë dhe teknikë. Kompozimi i vëllimeve, trajtimi arkitektonik i pamjeve të jashtme e të brendshme, si dhe zgjidhja planimetrike e funksionale e këtyre monumenteve nuk mund të ndryshohen.

b) “Monument kulture i kategorisë II” është ndërtimi me vlera të spikatura kryesisht për pamjen e tij të jashtme, i cili ruhet në vëllime dhe përbërje arkitektonike të këtyre pamjeve të jashtme.

37. “Muze” është institucioni i ruajtjes së kujtesës, në shërbim të shoqërisë dhe zhvillimit të saj, i hapur për publikun, që konservon, studion, komunikon dhe prezanton trashëgiminë e luajtshme e të paluajtshme të njerëzimit dhe mjedisit rrethues të tij, me qëllim edukimin, studimin, promovimin dhe argëtimin.

38. “Objekt muzeor” është një pasuri e luajtshme, që, pas hulumtimeve dhe vlerësimit, njihet si një objekt me rëndësi kulturore e historike, që ruhet, mbrohet, administrohet dhe vlerësohet në një muze.

39. “Parandalim” është tërësia e veprimeve për kufizimin e situatave të rrezikut, të lidhura me pasurinë kulturore në kontekstin e saj.

40. “Pasuri kulturore materiale” është tërësia e pasurive të luajtshme e të paluajtshme që, sipas përcaktimeve të neneve 50 dhe 51 të këtij ligji, kanë interes artistik, historik, arkeologjik, arkitektonik, urbanistik, etnografik, arkivistik, bibliofilik, si dhe objekte të tjera, të përcaktuara ose parashikuara nga ligji si bartës të pasurive të qytetërimeve;

42. “Pasuri kulturore jomateriale” janë vlerat kulturore jomateriale, praktikat, paraqitjet, shprehjet, njohuritë, dijet, veprat, objektet, artefaktet e hapësirat kulturore që i krijojnë dhe bashkëshoqërojnë ato, të cilat, bashkësitë, grupet dhe individët i pranojnë si pjesë përbërëse të trashëgimisë së tyre kulturore. Ato krijohen dhe përcillen brez pas brezi, të ndikuara nga mjedisi e historia, të cilat u japin atyre identitet dhe vazhdimësi biokulturore;

43. “Pasuri peizazhi kulturor” është pjesë territori, karakteri i të cilave është formuar nga veprimi i faktorëve natyrorë dhe/ose njerëzorë, si dhe nga ndërveprimi i tyre, që kanë interes historik, kulturor, natyror, morfologjik dhe estetik;

44. “Pasuri arkeologjike” janë monumente, vendbanime historike të llojeve të ndryshme, objekte ose pjesë veprash ndërtimore apo vendbanimesh, të dala prej gërmimeve arkeologjike, me vlera historiko-kulturore;

45. “Park arkeologjik” është territori i përcaktuar me kufij të qartë, që përfshin dëshmi të rëndësishme arkeologjike të mbitokës, nëntokës e nënujit dhe bashkëprani të pasurive historike, peizazhit kulturor, i organizuar me elemente të një muzeu në natyrë;

46. “Partnerë strategjikë” në fushën e trashëgimisë kulturore, janë personat fizikë dhe juridikë, të cilët, nga eksperiencia e tyre në fushë, vlera dhe cilësia e sponsorizimit, marrëveshja e gjatë e bashkëpunimit, shkëmbimi i vlerave intelektuale dhe burimeve njerëzore e financiare, intensiteti dhe kohëzgjatja e bashkëpunimit me qeverinë shqiptare ose ministrinë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe institucionet e saj të varësisë, vlerësohen si thelbësorë në zbatimin e politikave në fushën e trashëgimisë kulturore dhe sigurimin e objektivave të përbashkëta në zhvillimin e fushës;

47. “Plani i menaxhimit” është një dokument që përcakton në detaje të gjitha strategjitë dhe mjetet e nevojshme për mbrojtjen e trashëgimisë dhe, në të njëjtën kohë, duke iu përgjigjur nevojave të jetës bashkëkohore. Ai përmban dokumentet legjislative, financiare, administrative dhe të ruajtjes, përveç planeve të ruajtjes dhe monitorimit;

48. “Politika të ruajtjes” janë ndërhyrjet në shkallë të ndryshme, intensiteti i të cilave përcaktohet nga gjendja fizike, shkaqet e përkeqësimit dhe pritshmëria për të ardhmen e pasurisë kulturore që është duke u trajtuar;

49. “Qendër historike” është një territor i dallueshëm urban, përfaqësues e një periudhe historike ose një faze të zhvillimit të qytetit/fshatit, që përbëhet nga elemente të trashëgimisë kulturore materiale, ku përfshihen, përveç strukturës urbane, elemente arkitektonike, mjedisore, kulturore, historike, peizazhe, brenda dhe rreth zonës, dëshmitë arkeologjike, panoramat, profilet urbane, perspektivat dhe pikat e referencës...

(Diskutime pa mikrofon)

Po ne vendosëm që t’i lexojmë të gjitha. Keni durim? Duhet t’i lexojmë të gjitha se është pjesa më e rëndësishme e ligjit.

Ne këtë ligjin nuk e kalojmë dot sot të gjithin. Duhet të ulemi ...

(Diskutime pa mikrofon)

Përkufizimet duhen lexuar të gjitha, pastaj në ndryshimet nen për nen do të flasim për ndryshimet nen për nen.

49. “Raport vjetor i menaxhimit dhe ruajtjes së koleksionit” është raporti që hartohet nga çdo muze publik e privat dhe prezantohet pranë Këshillit Kombëtar të Muzeve. Të dhënat e raportit vjetor verifikohen nga një grup ekspertësh të Ministrisë së Kulturës në mënyrë periodike;

50. “Restaurimi” është vlerësimi i thelbit origjinal të vlerave të pasurive kulturore nëpërmjet ndërhyrjeve për ndalimin e degradimeve të mëtejshme, nxjerrjen në pah të vlerave kulturore dhe transmetimin e tyre. Në rastin e vlerave të trashëgimisë kulturore të paluajtshme, që gjenden në zona të deklaruara me rrezik sizmik, sipas ligjeve në fuqi, restaurimi përfshin edhe ndërhyrjet për përmirësim strukturor;

51. “Regjistri kombëtar i pasurive kulturore” është dokumenti shtetëror unik, ku pasqyrohen përbërësit e çdo certifikate pasurie kulturore, të krijuara në letër dhe/ose në formë elektronike, në pronësi publike e private, materiale dhe jomateriale në Republikën e Shqipërisë. Përcakton qëndrueshmërinë në terma cilësorë dhe sasiorë të pasurive kulturore kombëtare si dhe përgjegjësinë e institucioneve që i posedojnë për regjistrim e përditësim;

52—shi është ndryshuar me propozim të grupit të punës, që i la detyrë ministrisë dhe fondacionit të sjellë një definicion të përditësuar, sipas të gjitha dokumenteve juridike. Ka ardhur edhe propozimi që bën ministria për definicionin e kësaj.

52. “Rijetëzimi” është dhënia në përdorim e pasurisë kulturore për funksione administrative e social-kulturore, me kusht që projekti i rijetëzimit të mos dëmtojë vlerën e pasurisë kulturore.

53. “Ruajtja” është proces i vazhdueshëm, sistematik, i koordinuar dhe i programuar hulumtimi, studimi, kërkimi, dokumentimi, regjistrimi, parandalimi, mirëmbajtjeje, konservimi, restaurimi, përshtatjeje dhe vlerësimi të trashëgimisë kulturore;

54. “Ruajtje të trashëgimisë jomateriale” janë masat që synojnë jetëgjatësinë e trashëgimisë kulturore jomateriale, përfshirë këtu identifikimin, dokumentimin, kërkimin, ruajtjen, mbrojtjen, promovimin, vlerësimin, përcjelljen, nëpërmjet edukimit formal e joformal, si dhe rigjallërimin e aspekteve të ndryshme të kësaj trashëgimie;

55. “Ruajtja e objekteve muzeore” është tërësia e veprimeve që nga momenti kur një objekt muzeor hyn në muze, në lidhje me fitimin e pronësisë, regjistrimin në katalogun kombëtar, regjistrimin në listën kombëtare të pasurive kulturore, magazinimin, konservimin dhe restaurimin;

56. “Site” janë vepra të krijuara nga njeriu apo vepra të ndërthurura nëpërmjet aktivitetit natyror e njerëzor dhe zona që përfshijnë vende arkeologjike, që kanë një vlerë kulturore në aspektin historik, estetik, etnologjik apo antropologjik;

57. “Thesar kombëtar” është një vlerë kulturore me rëndësi të veçantë për shkencën, kulturën, natyrën ose zhvillimin teknologjik, shkatërrimi i së cilës, dëmtimi ose humbja do të përbënte humbje të pariparueshme për shoqërinë.

58. “Trashëgimi arkitektonike” janë pasuritë e përhershme, si më poshtë vijon:

a) monumente: të gjitha ndërtesat dhe strukturat me interes të spikatur historik, arkeologjik, artistik, shkencor, social ose teknik, duke përfshirë edhe anekset e tyre dhe pajisjet;

b) grupe ndërtesash: grupe homogjene të ndërtesave urbane ose rurale, të dukshme për interesin e tyre historik, arkeologjik, artistik, shkencor, social ose teknik, të cilat janë mjaft koherente për të formuar njësi topografike të caktueshme;

c) sitet: vepra të krijuara nga njeriu apo vepra të ndërthurura nëpërmjet aktivitetit natyror e njerëzor dhe zona që përfshijnë vende arkeologjike që kanë një vlerë kulturore në aspektin historik, estetik, etnologjik apo antropologjik.

59. “Trashëgimi kulturore” është tërësia e pasurive kulturore, materiale dhe jomateriale, të një individi, grupi ose shoqërie, e trashëguar nga e kaluara, që ruhet në të tashmen, për t’iu përçarur brezave në të ardhmen si pjesë pasurisë kombëtare të një vendi, të cilat shprehin vlerat identitetin, njohuritë, traditat, besimet, si dhe pasuritë kulturore të peizazhit;

60. “Trashëgimi arkeologjike” është pjesë e trashëgimisë kulturore, elemente të së cilës janë të gjitha gjurmët e ekzistencës së njerëzimit, ruajtja dhe studimi i të cilave lejojnë ndjekjen e zhvillimit të historisë së tij dhe marrëdhëniet e njerëzimit me mjedisin natyror;

61. “Veprimtari arkeologjike nënujore” janë gërmimet, sondazhet, kërkimet, zhvendosjet dhe shfaqet në zonën arkeologjike nënujore;

62. “Trashëgimi kulturore nënujore” janë të gjitha gjurmët e ekzistencës njerëzore, të cilat kanë një karakter kulturor, historik ose arkeologjik, që kanë qenë pjesërisht ose plotësisht nën ujë, periodikisht ose vazhdimisht, për të paktën 100 vjet, si:

a) objektet e karakterit parahistorik, vendet, strukturat, ndërtesat, veglat e punës dhe mbetjet njerëzore, së bashku me kontekstin e tyre arkeologjik dhe natyror;

b) anijet, avionët ose mjete të tjera, ose pjesë të tyre, ngarkesa e tyre apo përmbajtje të tjera, së bashku me kontekstin e tyre arkeologjik e natyror;

Tubacionet dhe kabllot e vendosura në shtratin detar nuk konsiderohen si trashëgimi kulturore nënujore. Instalimet e ndryshme nga tubacionet dhe kabllot, të vendosura në shtratin detar dhe që vazhdojnë të përdoren, nuk konsiderohen trashëgimi kulturore nënujore.

63. UNESCO është Organizata për Edukim, Shkencë dhe Kulturë e Kombeve të Bashkuara.

64. “Vlerë kulturore” është:

a) dëshmi materiale e jomateriale e pranisë dhe veprimtarisë njerëzore, fenomene apo peizazhe, të cilat janë të rëndësishme për individin, komunitetin apo shoqërinë si një e tërë dhe kanë vlerë shkencore apo kulturore;

b) dëshmi materiale ose jomateriale e pranisë dhe veprimtarisë njerëzore, e cila është domethënëse për institucionet fetare të regjistruara;

c) fragmente të objekteve arkeologjike, etnografike apo objekteve të tjera, që janë të fragmentarizuara, të cilat përbëjnë një pjesë të vogël të autenticitetit të objektit origjinal, që janë dëmtuar në masë të madhe, pa ndonjë vlerë të rëndësishme kulturore, shkencore ose artistike, dhe pjesa më e madhe e tyre mund të përkufizohet si materiale. Këto nuk janë subjekt i identifikimit, por janë të tilla kur janë pjesë e fondeve muzeore.

65. “Vlerësimi” është ushtrimi i funksioneve dhe veprimtarive që kanë për qëllim promovimin e zhvillimin e trashëgimisë kulturore, si dhe krijimin e kushteve më të mira për përdorimin dhe gëzimin publik të saj. Në lidhje me peizazhin kulturor, vlerësimi përfshin, gjithashtu, rikualifikimin e objekteve të paluajtshme dhe të hapësirave të vendosura në mbrojtje, të dëmtuara ose degraduara;

66. “Zonë arkeologjike” është vendi ose peizazhi natyror ku ka objekte të luajtshme ose të paluajtshme, të gërmuara ose jo, që janë gjendur ose gjenden në sipërfaqe, nën tokë ose nën ujërat territoriale shqiptare, që mund të studiohen duke përdorur metoda arkeologjike.

67. “Zonë mbrojtëse” është një territor i përcaktuar me kufij të qartë, jashtë qendrës historike, ansamblit arkitektonik/urban, kompleksit arkitektonik dhe monumentit të kulturës, roli i

së cilës është mbrojtja e vlerave të këtyre pasurive kulturore dhe sigurimi i dritës, perspektivës, peizazhit kulturor, shikimit, shijimit dhe përdorimit nga publiku.

A jemi dakord me të gjitha këto ndryshime?

Dakord.

Neni 6. Aksesit i publikut në trashëgiminë kulturore.

Te pika 1, në rreshtin e dytë është shtuar “për shfrytëzim nga ana e publikut”.

Jeni dakord?

Dakord.

Ndryshime të tjera nuk ka.

Neni 7. Ruajtja dhe mbrojtja e pasurive kulturore.

Në pikën 2 është ndryshuar një “s”, që është bërë “t” për arsye ortografike.

Gjerkund ku e kemi pasur këshillueset e kemi bërë detyrueset.

Dakord?

Miratohet neni 7.

Neni 8. Vlerësimi i trashëgimisë kulturore. Nuk ka ndryshime.

Dakord?

Unifikimin nuk e lexojmë gjithandej, se kemi rënë dakord. “Konsiston”, “është”, “duhet të zbatohet” bëhet “zbatimi”. Kemi marrë përsipër të bëjmë këto korrigjime me propozimin e Komisionit të Ligjeve.

Në draftin final do të kemi edhe rregullimet përkatëse.

Dakord me nenin 8?

Miratohet neni 8.

Neni 9. Miratohet! S’ka ndryshime.

Neni 10. Keni ndryshime në nenin 10, që i kemi në konsideratë? Jo.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ndryshon vetëm titulli: “Pasuritë kulturore të klasifikuara me rëndësi universale, me rëndësi kombëtare dhe thesare kombëtare”.

Dakord për ndryshimin?

Pika 1 riformulohet: “Me propozimin e ministritë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, Këshilli i Ministrave mund të vendosë kalimin e pasurive kulturore të paluajtshme me vlera arkeologjike dhe atyre që gëzojnë statusin “me rëndësi universale” ose “me rëndësi kombëtare”,

në pronësi shtetërore, në administrim institucioneve publike qendrore, pushtetit vendor, subjekteve juridike, të themeluara prej tyre, me qëllim miratimin, vlerësimin dhe kryerjen e aktiviteteve përkatëse konservuese e mbrojtëse të vlerave kulturore”.

Dakord?

Pika 2 formulohet: “Aktivitetet përkatëse ruajtëse e mbrojtëse të pasurive kulturore, sipas pikës 1, të këtij neni, si dhe çdo aktivitet tjetër shkencor, kulturor, arsimor, si dhe aktivitetet e lidhura me turizmin, do të kryhen në përputhje me parashikimet e këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi”.

Pika 3 riformulohet: “Kriteret dhe procedurat standarde të kalimit të pronës në administrim miratohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore. Ky udhëzim botohet në “Fletoren zyrtare”.

Pika 4 bëhet: “Pasuria kulturore e paluajtshme, e kaluar në administrim sipas pikës 1... Vetëm kjo ndryshon.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, jemi dakord me ndryshimet që pësoi neni 10? Pikat 5 dhe 6 ngelen të pandryshuara. Dakord?

Miratohet? Po.

Neni 11. Kemi ndryshime në nenin 11?

Pika 1 e nenit 11 formulohet: “Shteti siguron ruajtjen, mbrojtjen, vlerësimin dhe administrimin e trashëgimisë kulturore, në zbatim të dispozitave të këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi”.

Pikat e tjera s’kanë ndryshime.

Jemi dakord me nenin 11?

Miratohet!

Neni 12.

Pika 1 e nenit 12 riformulohet: “Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore ushtron funksionet e ruajtjes, mbrojtjes, vlerësimit dhe administrimit të pasurive kulturore në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi”.

Pika 2 riformulohet: “Ministri i ushtron këto funksione vetë ose nëpërmjet institucioneve të specializuara të fushës, në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe institucionet e

tjera shtetërore dhe privatët, në bazë të marrëveshjeve apo formave të bashkëpunimit të parashikuara në këtë ligj dhe në akte të tjera ligjore.”

Këto janë ndryshimet e nenit 12. Ka vetëm pesë pika. Neni 12 ka ndryshimet që ju lexova dhe ka pesë pika. Dakord për ndryshimet?

Miratohet!

Neni 13. Kemi ndryshime te pika “b”, ku thuhet: “propozon regjistrimin në Listën e Trashëgimisë Botërore të vlerave materiale dhe jomateriale të trashëgimisë kulturore kombëtare.”.

Gjithashtu edhe në pikën “c”: “deklaron “pasuri kulturore” dhe “thesare kombëtare” për vlerat kulturore të paluajtshme dhe të luajtshme.”

Pika “d”: “lëshon licenca për riprodhimin e vlerave kulturore.”

Nuk ka ndryshime të tjera. dakord me ndryshimet që lexova?

Miratohet!

Neni 14.

Pika 2 e nenit 14 formulohet si më poshtë vijon: “Funksionet e ruajtjes e të mbrojtjes, të parashikuara në këtë ligj, të cilat kanë si objekt dorëshkrime, autografe, korrespondenca, libra të shtypur para vitit 1500, koleksione bibliotekare si dhe libra të tjerë, vula, gdhendje, harta gjeografike, partitura muzikore, fotografi, pelikula dhe materiale të tjera audiovizive, të cilat nuk i përkasin pushtetit qendror, ushtrohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, në bazë të marrëveshjeve specifike me ministrinë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore. Përveç parashikimeve më sipër, mund të identifikohen mënyra të tjera koordinimi dhe bashkëpunimi me ministrinë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore në fushën e mbrojtjes së pasurive kulturore.”

Nuk ka ndryshime të tjera.

Dakord me nenin 14?

Ndryshimet janë bërë sipas Komisionit të Ligjeve dhe nesh. Kijeni parasysh këtë gjë!

Neni 15 ndryshon në titull: “Trashëgimia kulturore e bashkësive fetare”.

Në pikën 3 ka një ndryshim: “Brenda gjashtëmujorit të parë të çdo viti, bashkësitë fetare i paraqesin ministrit...”

Dakord me ndryshimet?

Miratohet!

Neni 16: “Shprehje të identitetit kulturor kolektiv”.

Nuk ka ndryshime. Vetëm është përmirësuar diçka lidhur rezolutën. Është hequr një pjesë e tepërt në pikën 1. Është hequr pjesa: “të miratuar në Paris, respektivisht më 3 nëntor 2003 dhe 20 nëntor 2005”, që janë të tepërta për këtë ligj.

Nuk ka nevojë për ndryshime të tjera. dakord?

Miratohet!

Neni 17: “Lista përfaqësuese e dukurive kulturore jomateriale të UNESCO-s”

Edhe këtu ka ca ndryshime lidhur me datat e rezolutave, që janë unifikuar me nenin 16.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Aty jam, te neni 17. Neni 17 ndryshon kështu: “Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore ndërmerr nisma për njohjen në nivel ndërkombëtar të vlerave kulturore jomateriale si dhe për regjistrimin, ndryshimin e emërtesave të këtyre vlerave në listën përfaqësuese të dukurive jomateriale të UNESCO-s, pas miratimit nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Jomateriale të propozimeve për regjistrimin e këtyre dukurive, mbështetur në kriteret e parashikuara nga konventa “Për ruajtjen e vlerave kulturore jomateriale”.”

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ismet Beqiraj – Po për vlera kulturore jomateriale, të cilat aktualisht janë regjistruar në UNESCO? Në mbështetje edhe të zbatimit e implementimit të këtij ligji, ka ndryshuar emërtimi i tyre? A nuk duhet shtuar edhe kjo: lidhur edhe me reregjistrimin sipas emërtimeve, në funksion të ligjit?

Milva Ekonomi – Pyetje e drejtë. Unë nuk të përgjigjem dot. Ja ku kemi përfaqësuesit e ministrisë.

Sofjan Jaupaj – Në fakt, në nenin 278, ne kemi vendosur një pikë ku thuhet: “Aktet nënligjore të ligjeve të mëparshme të trashëgimisë e të muzeve, të miratuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji, dhe që nuk bien ndesh me të, do të zbatohen, derisa nuk janë miratuar aktet nënligjore të parashikuara në këtë ligj”. Kështu, çfarë është miratuar do të vazhdojë të jetë në fuqi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Milva Ekonomi – Ato që janë regjistruar si pasuri e UNESCO-s. ka ndryshuar emërtimi.

Ismet Beqiraj – Më fal. që të jemi në një gjatësi vale edhe me një propozim, që edhe drejtuesja e sotme e komisionit, edhe zoti Muhamet e dinë: janë gati edhe 36 shoqata kulturore të folklorit kombëtar shqiptar të zonave të Jugut, të këngës labe.

Sofjan Jaupaj – Edhe unë nga Mallakastra jam.

Ismet Beqiraj – Ah, meqenëse je nga Mallakastër, shumë mirë!

Lidhur me një terminologji, që sot është regjistruar në UNESCO, dhe kërkohet nesër, nga iso-polifoni në polifoninë popullore shqiptare. Ky është një debat, që shumë akademikë, shumë muzikantë, duke cituar edhe të ndjerin Ramadan Sokoli, që është një ndër studiuesit më të mirë të folklorit shqiptar, kanë kërkuar që ta korrigjojnë. Meqenëse unë jam nga ajo zonë, e edhe ti je nga ajo zonë, në konceptin iso-polifoni, këngë labe, është polifonia popullore shqiptare. Këngë labe pa marrësin, thyesin, hedhësin dhe ison, nuk ka.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Konform këtij ligji, me ndryshimin e kësaj terminologjie, do t'i japim hapësirë, që është ndryshimet e reja, të vlerave kulturore jomateriale, që pasqyrojnë ndryshimet e reja në ligj. Ministria të ketë të drejtë të bëjë propozimin.

Sofjan Jaupaj – Tani, sipas ligjit që ne po miratojmë, propozimet nga shoqatat kulturore depozitohen pranë Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Jomateriale, edhe për ndryshimin e terminologjisë, iso-polifonisë. Ministria i bën propozimin UNESCO-s, që terminologjia iso-polifoni të ndryshojë e të bëhet polifonia shqiptare.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ismet Beqiraj – Ashtu si thuhet: “Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore ndërmerr nisma për njohjen në nivel kombëtar të vlerave kulturore jomateriale, si dhe regjistrimin e këtyre vlerave”, të ketë të drejtën edhe të propozojë ndryshimet që sot ekzistojnë të regjistruara. Ju thoni e nuk është objekt i këtij ligji.

Milva Ekonomi – Objekt i këtij ligji është, por këtë kërkesën tuaj, ju e keni depozituar me shkrim pranë komisionit, në momentin që diskutohej ligji nen për nen. Unë, së bashku me Muhametin, këtë kërkesën tuaj ia kemi çuar ministrisë në formë zyrtare, që të na japin përgjigje të gjithë juristët. Shpjegimi që na kanë dhënë, është pikërisht shpjegimi që po na jep sot Sofjani,

Kjo që ti ke merak, është pjesë e përfshirë në ligj, sepse është bërë e gjithë procedura që të jetë kështu. Nuk ka asnjë vend ku thuhet polifonia. Ke ndonjë emërtesë për pasurinë...?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Milva Ekonomi – Të lutem! Iris, e shikon pak atë nen që u bazove kur bërë komentin?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një minutë!

Të dëgjojmë edhe juristin, sepse ka bërë një shpjegim atë ditë kur diskutuam.

Sofjan Jaupaj - Ideja është që regjistrimi i isofonisë apo polifonisë shqiptare....

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ismet Beqiraj – Po flas në parim, është isopolifonia si element i diskutuar shumë vite, por mund të ketë edhe vlera kulturore jomateriale që janë regjistruar dhe nuk përshtaten me emërtimet që përfshihen në këtë ligj. Unë mora një rast.

Sofjan Jaupaj - Po, shumë e drejtë. Kjo nuk e pengon ministrinë të bëjë ndryshimet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ismet Beqiraj - Kemi ligjin, unë them ta fusim këtu.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Iris Hysi - Është çështje e teknikës legislative. Ne këtu vendosim parimin, pastaj rregullimin e bën VKM-ja përkatëse. Ne kemi aktualisht aktet në fuqi që rregullojnë çështjet e regjistrimit në UNESCO nga momenti i propozimit deri në momentin e miratimit final. Nuk mund të shpjegohet në ligj çdo detaj i rregullimit të çdo aspekti të trashëgimisë kulturore. Prandaj do të dalin edhe VKM-të në mbështetje të tij, rregulloret apo udhëzimet.

Ismet Beqiraj - Ashtu si fut regjistrimin duhet të fusësh edhe të drejtën që ka ministria t'i propozojë UNESCO-s për çregjistrimin ose për ndryshimin e emërtesave në përputhje me këtë ligj.

Sofjan Jaupaj - Ne mund të bëjmë vetëm për ndryshimin e emërtesave, por çregjistrimin nuk mund ta bëjmë. Çregjistrimi bëhet nga UNESCO. Në momentin që ajo dukuri nuk ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ismet Beqiraj - Jo, çregjistrimin, por ndryshimin e emërtesës.

Sofjan Jaupaj - Dakord.

Ismet Beqiraj – Regjistrim dhe ndryshim të emërtesës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Milva Ekonomi - Atëherë, biem dakord që neni 17 të merret në konsideratë me këtë shprehje: “ Nivelit ndërkombëtar të vlerave kulturore dhe materiale, si edhe për regjistrimin e tyre, ndryshimin e emërtesës së vlerave në listën përfaqësuese të dukurive në materialet e UNESCO-s”. Jeni dakord? E morët shënim?

Miratohet.

Sofjan Jaupaj – Dakord.

Milva Ekonomi- Neni 18. Ka ndryshime? Nuk ka.

Muhamet Bela - Ka diçka nga Komisioni i Ligjeve.

Milva Ekonomi- E ka riformuluar Komisioni i Ligjeve për ta bërë detyruese. Jeni dakord me nenin 18?

Miratohet.

Neni 19. Është shtuar një fjalë në titull: “Fondi Kombëtar i Kujdesit për Trashëgiminë Kulturore Materiale”. Ky ndryshim e shoqëron gjithandej ku janë fjalët “trashëgimi kulturore materiale”. Jeni dakord me ndryshimin?

Miratohet.

Neni 20. “Financimi për trashëgiminë kulturore”. Ky nen ndryshon nga “Financimi dhe masat fiskale për trashëgiminë kulturore” dhe bëhet “Financime për trashëgiminë kulturore”. Jeni dakord me ndryshimin në titull?

Miratohet.

Mbaruam me titullin e parë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Neni 21.

Pika 2 e nenit 20, që ka ndryshuar titullin, që është bërë “Financimi për trashëgiminë kulturore” hiqet. Pikat e tjera ndryshojnë numërimin sipas heqjes së pikës 2. Nenin e kemi me 5 pika. Jeni dakord me ndryshimet?

Miratohen.

E di pse ndodh kjo gjë?

(Ndërprerje e incizimit.)

Kapitulli i parë, titulli i parë, ishte diçka e rëndësishme, sepse kishte të bënte me definicionin dhe me ndryshimet për gjuhën që përdori Komisioni i Ligjeve. Komisioni i Ligjeve siç e shikoni edhe në materialin që keni ka vazhduar ndryshimet për teknikën legjislative, për gjuhën që duhet të përdoret në ligj, që të mos bien ndesh me akte të tjera nënligjore, ka bërë ndryshimet e domosdoshme në projektligjin që kemi përpara.

Unë do të lexoj ndryshimet që do të vijnë tani e tutje për të gjitha komentet që ka bërë grupi ynë i punës, grupet e interesit, profesorët e fushës sonë që kanë sjellë mendimet e tyre me shkrim. Mos harroni që ne grumbulluam rreth 50 faqe, komente për ndryshimin e këtij ligji. Të gjitha këto komente janë përfshirë në ligj.

Kreu I, me titull “Pasuritë e Paluajtshme.

Neni 21 “Të drejtat e pronarëve dhe të poseduesve të pasurive kulturore”. Edhe këtu, ky ligj ka pësuar ndryshime në bazë të Kushtetutës, të cilat janë sjellë nga Komisioni i Ligjeve. Jeni dakord për ndryshimet?

Miratohet.

Neni 22 “Detyrimet e pronarëve dhe të poseduesve të pasurisë kulturore”. Edhe këtu kemi një pjesë të germa ”b”, që ne e riformulojmë dhe themi: “ Informojnë institucionet e specializuara të trashëgimisë kulturore, inspektoratin përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për çdo dëmtim, zbulim apo çdo veprim të parashikuar në këtë ligj”. Jeni dakord me ndryshimin?

Miratohet neni 22.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Neni 23 “ Detyrimet për njoftim ...

(Ndërprerje e incizimit)

Në kohën që jemi duke punuar, ka ardhur edhe raporti final nga Komisioni për Integrimin, i cili ka sjellë 4 komente për ne. Në fund të projektligjit kërkon të vihet një *foot note* lidhur me direktivën e BE-së nr.2014/60/BE, pra sipas propozimit të tyre. Ky komision mendon që ta vendosim këtë rregullore si *foot note*. Kanë bërë një korrigjim te neni 5 i përkufizimeve ku bëhet fjalë për koleksionet publike, që i riformulojnë: “Koleksionet publike janë ato koleksione që janë të aksesueshme nga publiku pavarësisht të drejtave të pronësisë së mbajtësit, kur përfshihen objekte me interes artistik, dokumentarë historikë dhe shkencorë”. Pra, shtohen fjalët “nga publiku”. Jemi dakord me këto ndryshime në pikën 23 të nenit 5?

Miratohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nga Komisioni i Ligjeve na kanë ikur të gjitha licencat, sepse licencat, thonë ata, nuk rregullohen fare me këtë ligj, kanë ligj më vete, ka moskoordinim. Ndërkohë Komisioni për Integrimin ka sjellë një riformulim të licencës së eksportit.

Sofjan Jaupaj - Mendoj të ruajmë mendimin e Komisionit të Ligjeve.

Milva Ekonomi - Çfarë mendimi keni? Pra, ruajmë mendimin e Komisionit të Ligjeve, nuk pranohet kjo që ka ardhur.

Gazmend Bici – Te neni 5, pika 72, termi “kthim” të hiqet.

Sofjan Jaupaj Dakord. Edhe Komisioni i Ligjeve e ka shprehur si mendim.

Milva Ekonomi - Ne nuk e kemi fare “kthimin” këtu.

Sofjan Jaupaj- Po, sepse Komisioni i Ligjeve...

Milva Ekonomi – Keni punuar sipas Komisionit të Ligjeve. Dakord.

Kjo është marrë në konsideratë, sepse është marrë sipas propozimit të Komisionit të Ligjeve. Jeni dakord deri tani?

Miratoohen ndryshimet? Ramë dakord për dy, nuk ramë dakord për një. Ramë dakord për *foot note*-n. Kemi edhe disa diskutime që ata kanë bërë për nenin 122 dhe do ta shikojmë më pas.

Neni 23. E keni parasysh, kemi marrë në konsideratë gjuhën teknike të Komisionit të Ligjeve dhe përputhshmërinë legjislative. “Detyrimi për njoftimin dhe kryerjen e ndërhyrjes ruajtëse dhe mbrojtëse”. Jeni dakord?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sipas Komisionit të Ligjeve në fund të paragrafit të pikës 2 të nenit 23 është shënuar: “Të drejtat e pronarit, poseduesit sigurohen nëpërmjet zbatimit të procedurave të parashikuara në këtë ligj”. Është vendosur të parashikohen në këtë ligj. Jeni dakord me këtë ndryshim?

Miratohet.

Kreu II “Pasuritë e luajtshme”.

Neni 24 “Të drejtat e pronarëve dhe poseduesve të pasurive kulturore të luajtshme”. Kemi komente?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Keni ndonjë ide për këtë? Nuk keni.

Miratohet sipas Komisionit të Ligjeve.

Neni 25 “Detyrimet e pronarëve dhe poseduesve të pasurive kulturore të luajtshme”. Është formuluar sipas Komisionit të Ligjeve. Ka komente të tjera? Jemi dakord?

Miratohet.

Titulli III “Institucionet e specializuara në fushën e trashëgimisë kulturore”.

Neni 26 “Sistemi kombëtar për kujdesin ndaj trashëgimisë kulturore”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në pikën 2 është shtuar, sipas propozimit të komisionit tonë: pas “Akademisë së Shkencave” është vendosur “Akademia e Studimeve Albanologjike”. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 27 “Inspektorati Kombëtar për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore”.

(Diskutime pa mikrofon)

Milva Ekonomi – Në këtë nen kemi marrë në konsideratë ndryshimet e Komisionit të Ligjeve.

Dakord?

Miratohet.

Neni 28, “Institucione të specializuara”.

Edhe këtu kemi bërë ndryshime sipas komenteve që na kanë ardhur në komision nga Instituti i Arkivave dhe kemi vënë formulimin në germën “d”, “Institucionet e Rrjetit Arkivor Kombëtar”.

Dakord?

Miratohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Institucionet e Rrjetit Arkivor Kombëtar, jo Arkivi i Shtetit.

Dakord?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Germa “e” është hequr.

Dakord?

Miratohet.

Neni 29, “Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore”.

Edhe këtu janë marrë në konsideratë ndryshimet që ka bërë Komisioni i Ligjeve. Nga ana jonë ka pasur disa ndryshime të vogla në pikën 10, ku kemi hequr “për shërbime”, sepse IKTK-ja, për të kryer funksionet sipas këtij ligji, mbledh tarifa sipas parashikimeve të përcaktuara, se nuk mbledh vetëm tarifa për shërbime, por mbledh edhe tarifa të tjera.

Jeni dakord me këto ndryshime në nenin 29?

Miratohet.

Neni 30, “Kompetencat e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore”.

Këtu kemi marrë në konsideratë të gjitha ndryshimet që kanë ardhur nga Komisioni i Ligjeve. Ne nuk kemi asnjë ndryshim.

E hedhim në votim?

Miratohet.

Fidel, të të marr leje për një gjë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ta mbyllim me institucionet.

Neni 31, “Drejtoritë rajonale të trashëgimisë kulturore”.

E kemi marrë sipas Komisionit të Ligjeve, nuk kemi ndonjë ndryshim. Biem dakord, sepse detyrat kanë qenë hierarkike dhe i kemi kontrolluar.

Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 32, “Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore”.

E kemi marrë sipas Komisionit të Ligjeve. Nuk kemi komente.

Dakord?

Miratohet.

Neni 33, “Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale”.

Edhe këtu sipas Komisionit të Ligjeve. Ne nuk kemi pasur ndonjë koment.

Dakord?

Miratohet.

Neni 34, “Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit”.

Ka ardhur nga Komisioni i Ligjeve në komisionin tonë. Kemi dashur të shikojmë përputhshmërinë që ka me ligjin për arkivat e filmit. Kur ishim në diskutim, kërkuam edhe shpjegim të mëtëjshëm nga Komisioni i Ligjeve, sepse thamë të mos kishte mbivendosje. Komisioni i Ligjeve na sugjeroi që nenin 34 ta mbajmë siç është, të pandryshuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Shtetëror i Filmit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Apo jo?

Dakord?

Ju nga ministria nuk kishit ndonjë koment për këtë?

Sofjan Jaupaj– Jemi dakord.

Milva Ekonomi – Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 35, “Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë”.

Sipas Komisionit të Ligjeve. Ne nuk kemi pasur komente.

Dakord?

Miratohet.

Neni 36, “Institucione të tjera të specializuara”.

Edhe këtu kemi bërë po të njëjtin ndryshim te pika 1. Kemi shënuar “Institucionet e Rrjetit Arkivor Kombëtar” dhe kemi hequr “Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave”, duke qenë në përputhshmëri me të.

Dakord?

Nesër në orën 11:00 e kemi lënë të diskutojmë për titullin e katërt “Organet kolegjiale të trashëgimisë kulturore”, te neni 37.

(Diskutime pa mikrofon)

Doni ta bëni më herët?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më vonë? Në çfarë ore?

(Diskutime pa mikrofon)

11:00.

Personalisht, kam një problem tjetër, sepse nesër më kanë caktuar... Meqenëse Instituti i Statistikave ka kaluar në varësi të Kuvendit, ata nesër do të bëjnë një konferencë për statistikat rajonale...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne nuk e mbarojmë dot sot të gjithë këtë.

(Diskutime pa mikrofon)

Doni të shkojmë deri në gjysmë, të diskutojmë 100 nene sot?

Apo doni të bëjmë pushim tani?

Më thatë deri te 30-ta. Unë ju çova deri te 38-a.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

(Mungesë regjistrimi)

(Diskutime pa mikrofon)

Po të themi se do të jemi, ti nuk je. Do t’i themi...

Kujt do t’i themi nesër?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Beqja është jashtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

(Diskutime pa mikrofon)

Po pra, teksti integral me Komisionin e Ligjeve dhe komisionin tonë. Do të keni atë që është varianti i fundit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sofjan Jaupaj – Është gati e zbardhur, pra janë të gjitha të përfshira brenda.

(Diskutime pa mikrofon)

Milva Ekonomi – Nuk i bëjmë dot tani. Është më mirë ta bëjmë nesër, më dëgjoni mua, se mezi erdhëm deri këtu!

(Mungesë regjistrimi)

Ne bëme një propozim, ndryshuam diçka te neni 17. Do të vendoset ai propozim. Ndërkohë, ndryshuam edhe këtë që erdhi nga Komisioni i Integritetit, një që e morëm në konsideratë dhe *footnote*-in, që është *copy paste*, se nuk ka ndonjë gjë të madhe.

Sofjan Jaupaj – Në fakt, e kemi *footnote*-in.

Milva Ekonomi – Dakord.

Kur t’ia dërgoni Gazit dhe Muhametit në versionin final, Gazi dhe Muhameti, do ta shpërndajnë menjëherë tek të gjithë anëtarët e komisionit.

Nesër, deri në orën 09:00, do t’i keni lexuar të gjitha këto, që nga neni 38 e tutje?

Nesër në orën 9:00 të jemi këtu!

(Diskutime pa mikrofon)

(Mungesë regjistrimi)

MBYLLET MBLEDHJA

